



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*  
*Ministry of Culture, Youth and Sport*

**STRATEGJIA PËR RININË**  
2019-2023

**Qershor, 2019**

## **Përmbajtja**

<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>6</b>
<b>ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE .....</b>	<b>9</b>
<b>VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE .....</b>	<b>20</b>
<b>MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË .....</b>	<b>21</b>
<b>NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË .....</b>	<b>22</b>
<b>INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË .....</b>	<b>23</b>
<b>PLANI I VEPRIMIT .....</b>	<b>40</b>

## **LISTA E SHKURTESAVE**

<b>DiR</b>	Departamenti i Rinisë
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>PDV</b>	Platforma Digjitale për Vullnetarë
<b>USAID</b>	Agjencioni për Zhvillim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara
<b>UNICEF</b>	Fondi Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>KE</b>	Këshilli i Europës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
<b>NATO</b>	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
<b>ZRBR</b>	Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor
<b>ASK</b>	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
<b>OJQ</b>	Organizata Jo - Qeveritare
<b>RAE</b>	Romë, Ashkali dhe Egjiptas
<b>QR</b>	Qendra Rinore
<b>KVRL</b>	Këshilli për Veprim Rinor Lokal
<b>KQVR</b>	Këshilli Qëndror për Veprim Rinor

## **PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

Strategjia për Rininë 2019 - 2023 përfshirë planin e veprimit është një strategji gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të rinjtë. Ajo ka për synim përmirësimin e situatës së të rinjve të grup-moshave 15 - 24 vjeç, duke përfshirë të gjitha palët e interesit si nga sektori qeveritar ashtu edhe nga ai joqeveritar. Strategjia gjithashtu synon të nxitë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore veprimtaria e të cilave lidhet me rininë, si dhe ndërmjet organizmave qendrorë dhe atyre komunalë për të fuqizuar politikën dhe programet rinore.

Kjo politikë rinore fillon me përcaktim të hollësishëm të situatës së rinisë kosovare që nga prezantimi i qëndrimit të të rinjve në “thirrjen për të bërë ndryshime”, duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes në vendim marrje dhe në jetën publike, pjesëmarrjen në edukimin jo formal dhe informal, në punësueshmëri, edukim dhe promovim shëndetësor, në kulturë, sport dhe rekreacion.

Objektivat strategjike të përcaktuara janë:

1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive
2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës
3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

Qëllimi kryesor i gjithë këtyre temave është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikën më të mira evropiane, në veçanti me nevojat që i ka rinia në vendin tonë. Është mendim pragmatik se të rinjtë kosovarë janë gjithashtu të rinj evropianë dhe si të tillë ata duhet të synojnë që të realizojnë të drejta të njëjta sikurse edhe gjetiu në Evropë në fushën e pjesëmarrjes, edukimit, shëndetit, sigurisë njerëzore, punësimit, sportit, kulturës dhe rekreacionit. Temat që i përfshin strategjia kanë të inkorporuar përfshirjen sociale (gjinia, etnia, rinia rurale/urbane dhe grupet tjera të marginalizuara) si qasje e përgjithshme që do të merret parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve të planifikuara.

Objektivat strategjike, masat, aktivitetet dhe kostoja janë të shtjelluara më gjerësisht në matricën e Planit të Veprimit për Rini, në të cilin ndërlidhen aktivitetet konkrete dhe identifikohen sektorët përgjegjës brenda Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht DiR.

Po ashtu, një ndër qëllimet e kësaj strategjie është edhe përkrahja e të rinjve në fushën e inovacionit dhe të ideve kreative, lëmi e cila konsiderohet si një element i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e mundësive të reja për të rinjtë.

## HYRJE

Kosova, në krahasim me vendet e tjera evropiane, vazhdon të mbetet një vend me moshë mesatare të re, ku rreth 20% e popullatës dominohet nga mosha 15 - 24 vjeç, duke përbërë grupimin më të madh të forcës aktive në shoqëri dhe forcës së aftë për punë.

Strategjia për Rini dhe plani i veprimit përshkruan hapat për realizimin e objektivave, realizimin e aktiviteteve, përcaktimin e përgjegjësve dhe mjeteve të nevojshme financiare.

Strategjia është dokument strategjik që në përmbajtjen e tij përfshin interesat vitale dhe nevojat e të rinjve për periudhën kohore 2019 - 2023. Duke pasur parasysh nevojat e mëtejme dhe realizimin e kërkesave nga të rinjtë, si dhe paraqitjen e kërkesave në rrethana të reja lidhur me zhvillimet e sotme rinore në Kosovë, ndihet një nevojë e theksuar për të vazhduar rrugën e përkrahjes së rinisë. Strategjia është e bazuar në një konsensus të gjerë nga të gjitha palët e interes mbi objektivat strategjike, duke u bazuar në prioritetet qeveritare dhe nevojat e të rinjve, si dhe në dokumentet dhe ligjet ekzistuese që autorizojnë hartimin e strategjive kombëtare qeveritare. Dokumenti strategjik trajton preokupimet e kohës së sotme të të rinjve nga mosha 15 - 24 vjeç dhe politikat ndër sektoriale në përputhje me legjislacionin në fuqi të MKRS-së.

Gjithashtu, nevoja e vazhdueshme për përkrahjen e rinisë theksohet edhe në raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Së fundmi, edhe raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2017 dhe i publikuar në prill të vitit 2018, thekson që duhet punuar më tepër në drejtim të rritjes dhe fuqizimit të mobilitetit rinor, si dhe rekomandon që, si politikë sociale evropiane, të ndërmerren masa që lidhen me punësueshmërinë e të rinjve.

## METODOLOGJIA

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, Departamenti i Rinisë pranë MKRS ka filluar zhvillimin e dokumentit të ri strategjik për rininë. Kjo fazë e parë kishte për qëllim shtjellimin e politikave të shkruara në strategjinë e mëhershme, të cilat mbulonin fushat themelore të aktiviteteve të DiR.

Metodologjia specifike për shtjellimin e strategjisë ka buruar nga analiza e shumë faktorëve kyç të sukseseve dhe sfidave për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë, që janë identifikuar nga anëtarët e grupit punues gjatë punëtorive të përbashkëta për hartimin e strategjisë.

Në qasjen metodologjike për adresimin e kësaj objektivë janë përfshirë komponentët e mëposhtëm:

- 1) Hulumtimi sekondar: Janë shqyrtuar dokumentet relevante të zhvilluara nga ministritë relevante, qeverisjet lokale, Organizatat Rinore dhe agjencitë zhvillimore që veprojnë në fushën e rinisë.
- 2) Intervistimet cilësore: Janë realizuar me hisedarët kryesorë në fushën e rinisë, si: a) MKRS, b) Zyrat komunale për rini, c) Përfaqësues të Organizatave Rinore, dhe e) agjencitë zhvillimore që veprojnë në fushën e rinisë.

Gjithashtu, strategjia është bazuar në dokumentet vendore dhe ndërkombëtare duke analizuar raporte të ndryshme: raportet e brendshme të punës të MKRS-së dhe dokumentet tjera të hartuara nga shumë institucione qeveritare të cilat përfshijnë rininë si hisedar, përfshirë hulumtimet dhe analizat e agjencive zhvillimore lidhur me pozitën e të rinjve në vendin tonë.

Faza e përgatitjes së draftit përfshin një numër ngjarjesh, tryezash diskutimi, punëtori dhe takime me palët e interesit në fushën e rinisë. Gjithashtu kjo strategji merr parasysh 11 treguesit e politikave rinore të shtjelluara nga KE-ja, BE-ja si dhe Forumi Rinor European.

### *Konsultimet në nivel lokal dhe qendrorë*

Edhe pse është hartuar në kuadër të MKRS/DiR, strategjia është dokument i zbatueshëm për tërë rininë kosovare. Gjatë fazës së përgatitjes janë zhvilluar konsultime me rininë nëpër komuna, organizata rinore, organizata ndërkombëtare, zyrtarë komunalë për rini, si dhe të rinj të tjerë të interesuar të cilët kanë shprehur mendimet dhe rekomandimet e tyre për problemet konkrete me të cilat ballafaqohet rinia në vend.

### *Lidhja me strategjitë tjera institucionale*

Strategjia është dokument që gërsheton politikat e ndryshme ndër-institucionale dhe politikat ndër-sektoriale që i dedikohen zhvillimit rinor me qëllim të avancimit të të rinjve në Republikën e Kosovës. Lidhshmëria institucionale nënkupton aktivitete të përbashkëta për të përkrahur të rinjtë, të cilët përbëjnë pjesën vitale të jetës në Kosovë. Strategjia është në harmoni të plotë me strategjitë tjera zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtueshmëri me planin afatshkurtër dhe afatmesëm të buxhetit të shtetit.

*Strategjia Kosovare për Rini dhe Plani i Veprimit për Rininë mbështet mbi këto parime:*

*Parimi i ligjshmërisë:*

Strategjia Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë mbështeten në Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë, aktet nënligjore, dokumentet strategjike relevante të Qeverisë së Kosovës dhe në parimet universale për të drejtat e të rinjve.

*Parimi i pjesëmarrjes:*

Hartimi i Strategjisë, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet qendrore, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, dhe partnerët ndërkombëtar. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, përbën edhe një tipar dallues të kësaj strategjie. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të saj.

*Parimi i trajtimit të barabartë:*

Përfshinë mbështetjen e të rinjve pa marrë parasysh etninë, gjininë, përkatësinë sociale dhe duke respektuar në veçanti përkrahjen e të rinjve me nevoja të veçanta dhe të rinjve të marginalizuar.

*Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësi:*

Çështjet që i preokupojnë të rinjtë janë çështje ndër-sektoriale që janë para së gjithash përgjegjësi dhe obligim i ministrive të linjës dhe qeverisjes lokale, prandaj është i domosdoshëm shkëmbimi i informatave, përvojave dhe resurseve me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara në këtë dokument strategjik.

*Parimi për të drejtën e informimit:*

Nënkupton të drejtën për informim të të rinjve si dhe qasjen në informacione në të gjitha sferat e interesit të tyre institucional.

*Parimi i hartimit të strategjisë bazuar në dëshmi:*

Çështjet rinore ndryshojnë vazhdimisht, varësisht nga trendi aktual dhe nevojat e të rinjve. Kjo strategji synon të mbështes zbatimin e objektivave të parapara dhe të përkrahë hulumtimet e vazhdueshme që identifikojnë nevojat e të rinjve dhe mundësojnë zhvillimin e politikave rinore të mbështetura në të dhëna konkrete.

*Parimi i qëndrueshmërisë:*

Strategjia është konceptuar si një platformë synimesh që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Departamenti i Rinisë (DiR), si përgjegjës kryesor në bashkëpunim me partnerët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e strategjisë.

Institucionet, agjencitë zhvillimore dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti strategjik janë:

- 1 Zyra e Kryeministrit
- 2 MKRS
- 3 MPB
- 4 MPMS
- 5 MASHT
- 6 MF
- 7 KQVR
- 8 USAID
- 9 NDI
- 10 OSBE
- 11 UNICEF/ Innovations Lab
- 12 UNDP/UNV
- 13 UNFPA
- 14 Helvetas Swiss Intercooperation
- 15 GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
- 16 DVV International - Institut für Internationale Zusammenarbeit Des Deutschen  
Volkschochschul - Verbandes)
- 17 WORLD BANK - Banka Botërore
- 18 P14y International
- 19 Friedrich Ebert Stiftung (FES)
- 20 HELP - Hilfe Zur Selbsthilfe
- 21 Lux Development
- 22 European Commission
- 23 Qendrat Rinore
- 24 Organizatat Rinore
- 25 UN Childrens Fund
- 26 IOM - International Organization for Migration
- 27 RIINVEST



### 1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive

Nevoja për përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe politikë - bërje vazhdon të jetë e rëndësishme së veçantë. Që nga fushatat ndërgjegjësuese, të rinjtë të përfshirë në procese të rëndësishme politike bërëse dhe vendim marrëse, ngritjet e kapaciteteve të tyre që të jenë aktivisht të përfshirë, pjesëmarrja rinore në nivel të përgjithshëm përkundër që ka shënuar rritje dhe përmirësim, akoma vazhdon të mbetet sfiduese.

Është inkurajuese dhe mund të konsiderohet se komunat e Republikës së Kosovës, ndonëse me shumë probleme dhe kufizime financiare, kanë arritur një përparim shumë të mirë sa i përket zhvillimit të politikave komunale në nivel lokal. Përgjithësisht, niveli komunal, përfshirë organizatat dhe qendrat rinore kanë shënuar një përparim domethënës në rritjen e pjesëmarrjes rinore.

Nga hulumtimet e vazhdueshme të MKRS-së, politikat rinore në nivel lokal janë të hartuara nga komunat përkatëse dhe organizatat rinore. Edhe pse komunat kanë hartuar planet lokale për rini, jo të gjithat kanë të miratuar buxhetin. Kjo edhe bën që sektori i rinisë në ato komuna të funksionojë pjesërisht ose jo në tërë kapacitetin.

Lidhur me qëndrimet apo pikëpamjet e rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive, hulumtimet tregojnë se ka një rënie dramatike të interesimit të të rinjve në ngjarjet politike. Të rinjtë shprehin shumë më pak interes në qeverisjen vendore. Dy të tretat e të rinjve në Kosovë nuk diskutojnë ose diskutojnë rrallë për politikë me familjen apo të njohurit. Të rinjtë janë më të prirë për diskutime politike me familjen ose të njohurit kur kanë përfunduar nivele të larta të arsimit apo kur jetojnë në zona urbane. Gjithashtu, ndikimi i prindërve në pikëpamjet politike të të rinjve në Kosovë nuk është i lartë. Pothuajse një e treta e të rinjve në Kosovë nuk kanë të njëjtat pikëpamje dhe besime me prindërit e tyre.

Vetëm 10 për qind e të rinjve kosovarë janë të mendimit që interesat e tyre janë të përfaqësuara “mirë” në politikën kombëtare. Kjo pikëpamje mbi *mungesën e përfaqësimit* është pothuajse e njëjtë në aspektet kryesore demografike të popullsisë së re (urbane, gjini, moshë, etj.). Të rinjtë e Kosovës e kanë të vështirë të përcaktojnë se cilit drejtimi politik i përketin “të majtës” apo “të djathtës”. Sa i përket pozicionimit në shkallë në drejtim të anëve politike të majta - të djathta, të rinjtë priren të kenë problem me të kuptuarit e këtyre kategorive dhe pozicionimin e tyre në shkallë. Një shumicë e vogël e të anketuarve besojnë se kanë orientim politik “të krahut të djathtë”, por mbështesin opinionet “e krahut të majtë” mbi çështjet ekonomike dhe sociale, si dhe rolin e shtetit në sigurimin e mirëqenies sociale. Ekziston një mosbesim dhe apati e të rinjve kosovarë ndaj të gjitha institucioneve politike, veçanërisht për partitë politike dhe qeverinë kombëtare. Për më tepër, ekziston një skepticizëm i madh tek të rinjtë rreth organizatave të shoqërisë civ- ile dhe mediave. Nga ana tjetër, ka më shumë besim tek institucionet fetare dhe organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OSBE. Shprehja e një pozicioni politik përmes aktivizimit qytetar nuk është e përhapur, pasi

vetëm 13 për qind kanë marrë pjesë në aktivitete të shoqërisë civile si vullnetarë. Të rinjtë që jetojnë në zonat urbane dhe janë anëtarë të familjeve në pozicione më të mira ekonomike janë më të prirë për të marrë pjesë në aktivitete politike. Edhe pse ekziston një nivel i lartë zhgënjimi me situatën në të gjitha fushat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të tashmen dhe të ardhmen, të rinjtë në Kosovë ndjehen mjaft optimist në parashikimin e tyre për të ardhmen, pasi 62 për qind e tyre mendojnë se situata ekonomike e njerëzve në Kosovë do të përmirësohet në 10 vitet e ardhshme. Të rinjtë që janë pjesë e familjeve me kushte jo të favorshme ekonomike janë më optimistë për të ardhmen, së bashku me të rinjtë që jetojnë në zonat rurale<sup>1</sup>.

## **Organizatave Rinore**

Strategjia për Rininë parasheh angazhimin e Organizatave Rinore për të përbushur masat dhe objektivat e planifikuara. Në kontekstin e këtij dokumenti strategjik, me Organizatave Rinore nënkuptohet çdo organizatë formale që grupin përfitues kryesor e ka rininë prej 15 deri 24 vjeç, dhe e cila është regjistruar në kuadër të Ligjit për Lirinë e Asocijimit të Republikës së Kosovës (04/L-57). Organizatave Rinore janë edhe rrjetet e formalizuara rinore që veprojnë në vend, si psh Këshilli Qendror i Veprimit Rinor (KQVR) ose rrjetet e përkrahura nga agjencitë e ndryshme zhvillimore që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Këshillet e Veprimit Rinor Lokal (KVRL) gjithashtu janë Organizatave Rinore të formalizuara të cilat, në momentin e regjistrimit si OJQ, i nënshtrohen parimit të konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi lidhur me konkurrencën, njëjtë sikur të gjitha OJQ-të rinore vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës.

## **2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës**

Kjo objektive strategjike planifikon ndërmarrjen e dy grupeve të masave, atë të edukimit jo formal dhe të mundësive për kyçje në tregun e punës.

### *2.1 Zhvillimi i edukimit jo formal*

Gjersa në vendet e përparuara edukimin jashtë një sistemi të strukturuar të arsimit e ndajnë në edukim jo formal dhe edukim informal, në vendin tonë deri vonë është konsideruar si një i vetëm. Edukimi jo formal, i organizuar në çfarëdo forme, mund të jetë apo të mos jetë i udhëhequr nga ndonjë planprogram formal. Ky lloj i edukimit mund të udhëhiqet nga ndonjë mësues i kualifikuar apo nga ndonjë lider me më tepër përvojë. Edhe pse nuk rezultohet në fund me ndonjë gradim apo diploma, edukimi jo formal pasuron dhe ndërton shkathtësitë dhe kapacitetet e një të riu. Edukimi informal një të riu i jep shkathtësi dhe përvoja të jetës asisoi ku gjërat mësohen në mënyrë të hapur. Përgjatë edukimit informal një i ri nuk i mëson gjërat në ndonjë klasë apo në ndonjë mënyrë sistematike. Edukimi informal për një të ri janë njohja me vlerat e jetës, zakonet, rregullat e mirësjelljes, arsyeshmëria e së keqes apo e mirës, traditat familjare, etika etj, me një fjalë secili aspekt që mëson nga natyra dhe vëzhgimi. Në këtë dokument është me rëndësi të bëhet dallimi ndërmjet këtyre dy llojeve

---

<sup>1</sup> Kosovo Youth Study 2018/2019, The Friedrich-Erbert-Stiftung/FES

të edukimit, meqë planifikohen veprime që të rinjve zhvillohen kapacitetet dhe shkathtësitë veçmas edukimit jo formal dhe atij informal.

Strategjia planifikon të promovojë zhvillimin e edukimit jo formal dhe bashkëpunimin e rritur institucional në krijimin e një kulture të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Edukimi global është edukimi që hap sytë dhe mendjet e njerëzve ndaj realiteteve të botës së globalizuar dhe i zgjon ata për një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë. Edukimi global, si dimension i global i edukimit për qytetari, përfshin edukimin për zhvillim, për të drejtat e njeriut, për qëndrueshmëri, për paqe, atë ndërkulturor, si dhe për parandalimin e konfliktit.

MKRS/DiR, dokumentet strategjike i ka hartuar në baza profesionale dhe hulumtime dhe vlerësime, dhe gjithë kohës monitoron zhvillimin e sistemit të edukimit për të rinj, zhvillon forma dhe programe të ndryshme për të përmirësuar nxënien e dijes përmes edukimit jo formal dhe informal. MKRS/DiR planifikon zhvillimin e aktiviteteve për ruajtjen e paqes, respektimin e të drejtave të njeriut, demokracisë, tolerancës, humanitetit, pjesëmarrjes së të rinjve në vendim marrje, mbrojtje të mjedisit, siguri të të rinjve, promovimin shëndetësor, promovimi i vullnetarizmit, zhvillimin kulturor e ndërkulturor, ndërmarrësinë, sportin dhe bashkëpunimin ndërmjet të rinjve.

Edukimi jo formal përkufizohet nga proceset, programet, projektet dhe aktivitetet që realizohen jashtë sistemit të edukimit formal me qëllim të përmirësimit të njohurive, shkathtësive dhe të kompetencave tek të rinjtë. Për këtë arsye ky edukim ofrohet përmes konferencave, trajnimeve, seminareve, tryezave, kampeve, debateve, punëtorive, shkëmbimit të përvojave përmes të realizimit të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale brenda dhe jashtë vendit, duke dhënë disa njohuri specifike ose aftësi që mund t'i ndihmojnë të rinjtë për të diversifikuar resumenë e tyre dhe më gjerë, duke u krijuar mundësi të rinjve të ripërtërinë arsimimin e tyre dhe të vazhdojnë me procesin e të mësuarit rreth karrierës në fushën e tyre apo në fusha tjera. Edukimi jo formal si komponent mjaft e rëndësishme e zhvillimit intelektual tek të rinjtë është një prioritet i vazhdueshëm të cilin DiR do ta mbështetë. Ngjarjet të cilat e zhvillojnë edukimin jo formal do të konsiderohen shume të rëndësishme për edukimin e të rinjve dhe në këtë mënyrë do të inkurajohen të gjitha Organizatat Rinore që komponentën e edukimit jo formal ta kenë sa më të përhapur dhe sa më të zhvilluar në ofertën për përfituesit e shërbimeve të tyre. Aktivitetet e edukimit jo formal planifikohet të jenë mirë të organizuara e të strukturuar, të mbështetura në kritere të përcaktuara përmes trajnimeve, punëtorive, kurseve, seminareve, tryezave diskutuese, kampeve, shkëmbit të përvojave etj. Këto organizime planifikohen të kryhen nga DiR me përkrahjen e komunave dhe të Organizatave Rinore

Përmes aktiviteteve zhvilluese personale dhe sociale që ofrohen, të rinjtë nxiten dhe ndihmohen të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që përmenden shpesh si të nevojshme në tregun e punës. Gjithashtu ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë përmes edukimit jo formal dhe informal mbështet zhvillimin e tyre, duke ndihmuar në transformimin e potencialit, kreativitetit, talentit, iniciativës dhe përgjegjësisë sociale, nëpërmjet përvetësimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave. Kësisoj ndihmohen të rinjtë të shqyrtojnë

çështjet me mendje të hapur dhe kritike, të reflektojnë për to dhe të jenë të gatshëm të rishqyrtojnë opinionet e tyre në dritën e fakteve të reja dhe të argumenteve të arsyeshme; të aftësohen të njohin dhe të sfidojnë njëanshmëritë, indoktrinimin dhe propagandën; të ndryshojnë këndvështrimin e tyre dhe të vështrojnë situatat në një tjetër këndvështrim; të zhvillojnë aftësitë për dialog të tilla si dëgjimi aktiv, respekti për opinionin e të tjerëve dhe pohimi i vetvetes në mënyrë konstruktive; të aftësohen që të përballen me konfliktet dhe t'i trajtojnë ato në mënyrë konstruktive dhe sistematike; të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe të ndërmarrin nisma përmes procedurave demokratike. Republika e Kosovës ka një popullsi në rritje ku dominojnë grup-moshat më të reja. Të rinjtë dhe të rejtat në moshë më të re se 25 vjeç përfaqësojnë 49 përqind të popullsisë, ndërsa 19.1 përqind të të rinjve janë në moshën 15 vjeçare.

Lidhur me punësueshmërinë e të rinjve hulumtimet e fundit tregojnë se Kosova ka një nivel të lartë prej 25 për qind të NEET (të rinjtë që nuk arsimohen apo trajnohen). Pabarazia gjinore në statusin social është shumë e lartë. Femrat kanë nivele të lartë NEET dhe arsimimi, ndërsa meshkujt janë më prezentë në tregun e punës. Papunësia është më e përhapur ndër të rinjtë me prindër të një niveli të ulët arsimor, që vijnë nga familje të varfra dhe në përgjithësi nga zona rurale. Perceptimi mbizotërues është se njohjet dhe lidhjet me njerëz në pushtet tregojnë pozicionin e individit në strukturën shoqërore dhe konsiderohet si faktor shumë i rëndësishëm për të gjetur një punë në 54 - 59 për qind të rasteve. Për më tepër, arsimi dhe përvoja e punës kanë të njëjtin ndikim.

Hulumtimet gjithashtu tregojnë se të rinjtë në Kosovë shpesh janë të aftë (54 për qind e tyre) për të punuar punë brenda profesionit të tyre. Kjo tregon një mospërputhje të lartë ndërmjet kualifikimeve të forcës së punës dhe nevojave dhe kërkesave të tregut për fuqi punëtore. Femrat duket se kanë prirje më të lartë për të punuar në profesionin e tyre. Shifra e habitshme për perspektivën më të preferuar të punësimit është se 70 për qind e të rinjve duan të punojnë në sektorin publik dhe vetëm 23 për qind në sektorin privat. Dëshira për të punuar për sektorin publik është mjaft problematike në krahasim me vendet e tjera në rajon. Vetëm 18 për qind e të rinjve të punësuar në Kosovë po punojnë në sektorin publik, ndërkohë që mospërputhja ndërmjet gjendjes reale dhe preferencave është më e larta në rajon. Siguria e punës është faktori kryesor që të rinjtë në Kosovë konsiderojë në zgjedhjen e një pune. Kjo nënkupton një shqetësim të madh mbi të drejtat e punonjësve, orët e gjata të punës, problemet me pagat, etj. Ata që janë më të shqetësuar për sigurinë e punës kanë dëshirë më të lartë për të punuar në sektorin publik dhe janë më pak të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë. Lidhur me shkathtësitë e të rinjve hulumtimet tregojnë se ka shpërputhje të dukshme. Të rinjtë në Kosovë janë shpesh (54 për qind e tyre) duke punuar në punë jashtë profesionit të tyre. Prej të rinjve që aktualisht janë të punësuar, vetëm 27 për qind janë aktualisht duke punuar në profesionin e tyre të zgjedhur, ndërsa 9 për qind bëjnë punë që kanë lidhje me profesionin e tyre. Nga ana tjetër, ka një rritje të lartë të të rinjve që deklarojnë se nuk punojnë në profesionin e tyre, me një kalim nga 36 për qind në 54 për qind të të rinjve që janë pjesë e fuqisë punëtore në gjashtë vitet e fundit. Kjo tregon një mospërputhje të madhe ndërmjet kualifikimeve të forcës së punës dhe nevojave dhe kërkesës së tregut për fuqi

punëtore. Femrat duken se kanë një tendencë më të lartë për të punuar në profesionin e tyre, ndërsa djemtë priren të mos punojnë në profesionin e tyre<sup>2</sup>.

Edukimi jo formal duket se është ai për të cilin rinia ka më së shumti nevojë. Është i përhapur në formë të njëjtë në të gjitha vendet e përparuara, ku iu mundësohet të rinjve të kenë ndikim në rrethin e tyre, të dinë si të ndërmarrin dhe tejçojnë iniciativat e tyre, e me radhë. Andaj dhe duhet ndjekur kjo formë veprimi, që përveç studimeve të thelluara në një fushë, të rinjtë mësojnë edhe si të komunikojnë, prezantojnë, përdorin gjuhën në mënyrë të plotë dhe të saktë, thellojnë aftësitë për t'i përdorë njohuritë e fituara, përshtaten me grupe dhe punë, aftësohen për të zgjidhur apo menaxhuar situata të ndryshme, për të qenë të efektshëm, për të analizuar e të tjera më radhë. DiR, përmes edukimit jo formalme qëllim që të arrijë të edukojë të rinjtë, duhet të përmbushë katër qëllime bazike: 1) qëllimin ekonomik, sipas të cilit duhet t'i aftësojë të rinjtë që të jenë ekonomikisht të përgjegjshëm dhe të pavarur; 2) qëllimin kulturor, sipas të cilit duhet t'i aftësojë të rinjtë që të kuptojnë kulturën e tyre dhe të respektojnë diversitetin; 3) qëllimin social, sipas të cilit duhet t'i aftësojë të rinjtë që të jenë qytetarë aktivë; dhe 4) qëllimin personal, sipas të cilit duhet t'i aftësojë të rinjtë që të njohin botën e tyre të brendshme dhe mjedisin që i rrethon.

## *2.2 Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës*

Sipas ASK (TM3 2018), 28.8% e të papunëve në Kosovë janë të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 12.0 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (55.0%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (62.5 %) krahasuar me meshkujt (51.8%). Gjithashtu, të rinjtë në Kosovë kanë dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me shifra pothuajse të ngjashme për meshkujt dhe femrat<sup>3</sup>.

Kur kemi të bëjmë me mundësinë për të zgjedhur vendin e punës, vetëm një pjesë e vogël e rinisë në Kosovë është pjesë e forcës së punës. Shifra e habitshme mbi perspektivën më të preferuar të punësimit është se 70 për qind e të rinjve (sipas hulumtimit të FES Youth Study Kosovo 2018/2019) duan të punojnë në sektorin publik dhe vetëm 23 për qind në sektorin privat. Vetëm 47 për qind e të rinjve kosovarë preferonin një punë në sektorin publik në 2012. Vlen për t'u përmendur rënia e qëllimeve të rinisë për të punuar për një institucion ndërkombëtar nga 19 për qind në 2012 në 5 për qind në 2018. Rënia e prezencës së institucioneve ndërkombëtare në Kosovë ka pasur implikime edhe në numrin e të rinjve kosovarë, që duan të punojnë për to.

Dëshira për të punuar për sektorin publik është problematike krahasuar me vendet e tjera në rajon. Vetëm 18 për qind e të rinjve të punësuar në Kosovë punojnë në sektorin publik, ndërsa mospërputhjet ndërmjet gjendjes reale dhe preferencave janë nga më të lartit në rajon. Femrat janë më të prira të punojnë në sektorin publik (71 për qind), ndërsa meshkujt kanë më shumë mundësi në sektorin privat. Tek faktorët në zgjedhjen e një vendi të punës, të rinjtë janë të orientuar kryesisht nga konsideratat e të drejtave të punës, që konsiderohen si shumë

<sup>2</sup> Youth Study Kosovo 2018/2019, The Friedrich-Erbert-Stiftung/FES

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës - Anketa e fuqisë punëtore, tetor 2018

të rëndësishme në 83 për qind të rasteve. Siguria në punë dhe koha e lirë përtej punës, konfirmojnë diskutimet e fokus grupeve se shqetësimet kryesore të punonjësve në sektorin privat janë të drejtat e punonjësve, orët e gjata të punës dhe problemet me pagën. Ka disa lidhje të rëndësishme statistikore lidhur me sigurinë e punës së të rinjve në Kosovë. Ata që janë të shqetësuar për sigurinë në punë janë më të bindur se të ardhurat e të varfërve dhe të pasurve duhet të jenë të barabarta.

Përkeqësimi i kushteve të punës po i shtyn të rinjtë për të përkrahur më shumë politika të djathta. Në të njëjtën kohë, ata që janë të shqetësuar për sigurinë në punë në të njëjtën kohë janë të interesuar në politikë. Padyshim, ata kanë një dëshirë të madhe për të punuar në sektorin publik, pasi konsiderohet se ofron më shumë siguri në punë. Në të njëjtën kohë, ata që nuk kanë siguri në punë janë në përgjithësi të pakënaqur me cilësinë e arsimit, por nga ana tjetër duken më të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi. Të rinjtë që janë më të interesuar në të ardhura/paga, janë pak më prezentë në zonat rurale, dhe gjithashtu duken më të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi.

Në kushtet e sotme ekonomike, të rinjtë hasin vështirësi të shumta për të zhvilluar aktivitete ndërmarrëse. Mosnjohja e tregut të punës; mungesa e informacioneve për zhvillimin e rrethanave të tregut si ofertës dhe kërkesës në tregun e punës; edukimi jo i mirë në ndërmarrësi; mosnjohja e bazës ligjore për t'u marrë me ndërmarrësi; mungesa e zhvillimit ideor për të ndërmarrë iniciativa për themelimin e biznesit; mungesa e besimit në vete dhe ambientit të ndërmarrësisë nëse mund të kenë sukses; mungesa e njohurive mbi kreditë dhe lehtësimet që ofrojnë bankat për biznese janë disa nga faktorët që konsiderohen si problematik. Nga kjo pikëpamje është veçanërisht e rëndësishme të ofrohet mbështetje për bizneset e reja në ndërmarrësi, mentorim dhe udhëzime për ndërmarrësit e rinj, si dhe promovim dhe zhvillim i kulturës së ndërmarrësisë.

Nëse shohim dallimet e punësueshmërisë së të rinjve ndërmjet viseve rurale dhe urbane, hulumtimet e fundit tregojnë se të rinjtë e viseve rurale nuk kanë qasje të mjaftueshme në informacion rreth punësimit në Kosovë. Me vetëm 24.62% të punësuar dhe 75.8% të papunë, vërehet se shumica e të rinjve besojnë se posedimi i shkathtësive nuk është kriteri më i rëndësishëm për punësim, pasiqë rekomandimet, dhe lidhjet familjare dhe shoqërore janë mënyrat më të shpeshta për të gjetur punë në Kosovë.

Për sa i takon papunësisë në baza gjinore, rezultatet tregojnë se femrat janë në disavantazh në tregun e punës në raport me meshkujt, me 80.5% të të rejave rurale të papuna, në krahasim me 67.6% të meshkujve të papunë. Deficiti i shkathtësive në raport me mundësitë për punësim, dhe mospërputhja ndërmjet trajnimeve të ndjekura dhe vendeve të punës në zonat rurale, e bëjnë problematik punësimin e të rinjve.

Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve në tregun e punës, ekziston një dallim i madhe mes komunitetit shqiptar me një shkallë të lartë të punësimit prej 28% dhe komuniteteve më të vogla sikurse RAE me shkallë të punësimit prej vetëm 10.7%.

Mungesa e përfshirjes së grupeve të marginalizuara etnike në arsim dhe në tregun e punës, sidomos e komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian, sugjeron ekzistencën e problemeve serioze strukturore që ndikojnë në marginalizimin e komuniteteve të vogla etnike të Kosovës.

Pengesat për punësim janë të ndryshme dhe përfshijnë mungesën e mundësive, mungesën e vendeve të punës me gjysmë orari (për studentët), mungesën e vendeve të punës me orari fleksibil (studentët dhe prindërit e rinj), mungesën e transportit adekuat, dhe mungesën e shkathtësive të duhura të renditur në vendin e fundit.

Rezultatet e studimit të LENS tregojnë se shumica e të anketuarve janë të kënaqur me vendin aktual të punës. Sidoqoftë, më shumë se gjysma e të anketuarve të punësuar punojnë pa kontratë të punës. Shumica e të anketuarve kanë thënë se fshati i tyre nuk ofron mundësi të mira për punësim. Megjithatë, ata jetojnë në komunitete të organizuara mirë, në ambiente të shëndetshme dhe me lidhje të mira me qendrat urbane, që e lehtëson kërkimin për punë.

Edhe pse kushtet e jetesës së rinisë rurale janë të kënaqshme, pavarësisht prej shkallës së lartë të papunësisë, niveli i varësisë nga përkrahja e familjes është e lartë. Kjo varësi rritet nga remitancat nga jashtë dhe nga skemat e asistencës sociale. Me një mbështetje të tillë, pavarësisht prej shkallës së lartë të papunësisë, pothuajse të gjithë të anketuarit kanë telefona mobilë, kompjuterë dhe lloptopë, TV, vetura personale apo familjare dhe mjete të tjera shtëpiake.

Paga nuk është faktori kryesor i motivimit për shumicën e rinisë rurale. Mjedisi në punë dhe liria e shprehjes janë të renditura si faktorët kryesorë motivues, të pasuara nga kolegët e mirë, orari i punës, mundësia për avansim profesional, dhe niveli i pagës.

Shumica e të rinjve të papunë në viset rurale kanë nevojë për punë, pasuar nga aftësia për të shkruar biografinë (CV), vlerësimin e shkathtësive të tyre, përdorimin e teknologjisë informative (TI) dhe internetit, këshillim për karrierë, lehtësim për punësim, etj. Kjo përputhet me gjetjet e studimeve paraprake, sipas të cilave shkathtësitë e buta, siç janë shkathtësitë e komunikimit, të qenit të hapur ndaj aktiviteteve sociale dhe të qenit të hapur ndaj kulturave organizative të ndërmarrjeve, janë shkathtësitë kryesore të kërkuara nga punëdhënësit<sup>4</sup>.

Kur jemi tek migrimi, mungesa e shpresës për të gjetur një punësim të mirë dhe përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike janë disa nga arsytet që shtojnë rreth 47 për qind të të rinjve shqiptarë të Kosovës që të kenë një qëllim nga i moderuar deri tek të fortë për të migruar në të ardhmen e afërt. Gjithashtu, pakënaqësia me arsimin, korrupsionin, besimi i ulët tek institucionet dhe çështje të tjera kenë çuar në rritjen e ankesave dhe pakënaqësisë, duke kontribuar drejt migracionit.

Vendet e pikë synuara nga të rinjtë mbeten Zvicra dhe Gjermania, që pasqyrojnë ndikimin e diasporës së madhe kosovare në këto dy vende. Një numër i madh i të rinjve nga Kosova do të pranonin punë që nuk do merreshin në konsideratë nga popullsia lokale. Përveç kësaj, motivimi për të migruar për arsye arsimore mbetet relativisht i ulët, duke krijuar një prishje ekuilibri midis dës- hirës për të migruar dhe punuar në vendin e destinacionit dhe etjen për një arsim të huaj dhe më të mirë, që në vetvete mund të sjell shanse më të mira për punë në vendin e destinacionit<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> Rinia Rurale e Kosovës - Mundësitë, pengesat dhe nevojat për punësim, 2018

<sup>5</sup> Youth Study Kosovo 2018/2019, The Friedrich-Erbert-Stiftung/FES

Andaj, është e një rëndësie jetike që të realizohen aktivitetet e planifikuara në këtë dokument strategjik, ashtu që rinia të ketë një përkrhaje më të madhe, duke iu ofruar trajnime të nevojshme për ngritjen e shkathtësive jetësore në mënyrë që të përgatiten për tregun e punës dhe ushtrim të praktikës në punë, duke synuar kështu përfitimin e përvojës dhe duke nxitur inovacionin për ndërmarrësit e rinj.

### 3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

Për të siguruar mjedisin e shëndetshëm dhe të sigurtë për rininë kosovare, DiR ka planifikuar tre grupe të masave, të ndarë në kujdesin për arritjen e mjedisit të shëndetshëm të rinisë, dhe në arritjen e një sigurie më të lartë për rininë kosovare dhe mbështetjen e aktiviteteve që ndikojnë në integrim shoqëror e kulturor.

#### *3.1 Promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenjes së të rinjve*

Sipas të dhënave nga hulumtimet e ndryshme, promovimi dhe edukimi shëndetësor duhet të vazhdojë të përkrahë promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenien e të rinjve.

Sipas hulumtimit të Global Youth Tobacco Survey GYTS 2016, i cili është realizuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) në Kosovë për të rinjtë e moshës 13-15 vjeç dhe jep të dhëna për vlerësimet e çastit në nivel vendi del se: 8.8% e nxënësve (11.7% e djemve dhe 5.6% e vajzave), kanë përdorë ndonjë produkt të duhanit. 7.1% e nxënësve (10.1% e djemve dhe 4.0%) e vajzave kanë tymosur duhan. Sa i përket duhanpirjes pasive 47.8% e të rinjve ishin ekspozuar ndaj tymit të duhanit në shtëpi dhe 43.7% ishin ekspozuar ndaj tymit të duhanit brenda vendeve të mbyllura publike. Lidhur me qasjen dhe disponueshmërinë e duhanit është gjetur se: 75.6% e duhanpirësve furnizohen duke i blerë në shitore, shitës rruge apo kiosk. Nga duhanpirësit aktualë 68.7% kanë deklaruar se nuk janë penguar gjatë blerjes së duhanit për shkak të moshës. Po ashtu është i lartë numri i studentëve që kanë shprehur dëshirën të lënë duhanin (60.3%), ndërsa 58.9% kanë tentuar ta lënë duhanin. 36.7% e të rinjve janë të ekspozuar ndaj reklamimit të duhanit dhe 6.1% të tyre u janë ofruar cigare falas nga kompanitë e duhanit. Nga pyetjet për ekspozimin ndaj reklamimit të duhanit del se 7 në 10 nxënës kanë vënë re mesazhe anti-duhan në media; gati 4 në 10 nxënës kanë vënë re reklama ose promovime të duhanit në pikat e shitjes dhe 1 në 10 nxënës ka diçka në pronësi me llogo nga markat e duhanit.

Sipas rezultateve të anketës, 71 për qind e të rinjve nuk pinë duhan dhe ky rezultat është identik me të njëjtën anketë të vitit 2012. Nëntëmbëdhjetë për qind e meshkujve duket se janë duhanpirës të rregullt, ndërsa vetëm shtatë për qind e vajzave pinë rregullisht duhan. Duhanpirja rregullisht mbizotëron midis të rinjve të moshave 24 -29 vjeç, dhe përqindja e jo-duhanpirësve zvogëlohet me rritjen e moshës, megjithëse përqindja e atyre që pinë duhan me raste është e njëjtë ndërmjet grupmoshave të ndryshme të të rinjve (9 -11 për qind). Zakonet e duhanpirjes janë të lidhura me rezultatet e indeksit të pasurisë, pasi të rinjtë që i përkasin



familjeve në gjendje më të mirë ekonomike, kanë prirje më të forta për të pirë duhan. Arsyeja më e përhapur e duhanpirjes duket është “të qenurit i përfshirë” dhe “thyerja e rregullave”. Në bazë të rezultateve të anketimit, 73 për qind e të rinjve nuk konsumojnë alkool dhe rezultatet nuk kanë ndryshuar në gjashtë vitet e fundit. Pesë për qind e të rinjve raportojnë konsumimin e alkoolit të paktën disa herë në javë. Përgjithësisht, konsumimi i alkoolit është i përhapur në 25 për qind të të rinjve, duke përfshirë ata që pinë rregullisht dhe ata që janë konsumues të rrallë. Konsumimi është 33 për qind për meshkujt dhe vetëm 16 për qind për femrat.

Nuk është për t’u habitur që konsumimi i alkoolit gjatë javës rritet me moshën nga 5 deri 17 për qind. Duhanpirja dhe konsumimi i alkoolit në rini është shumë i ndërlidhur. Për më tepër, konsumimi i alkoolit lidhet me indeksin e pasurisë, pasi të rinjtë që i përkasin familjeve në një gjendje të mirë ekonomike priren më tepër për të konsumuar alkool. Të rinjtë në zonat urbane kanë një prirje më të fortë për të pirë, krahasuar me grupin e tyre të bashkëmoshatarëve ruralë. Në bazë të gjetjeve sasiore, konsumimi i alkoolit është i papranueshëm për 60 për qind të të anketuarve. Për më tepër, pranimi pjesërisht i përdorimit të alkoolit është statistikisht i lidhur me gjininë, rezidencën, moshën dhe indeksin e pasurisë së të anketuarve. Profili i të rinjve që konsiderojnë alkoolin më të pranueshëm është meshkuj, që jeton në zona urbane, me arsim të lartë, dhe duke pasur një rezultat të mirë të indeksit të pasurisë<sup>6</sup>.

Nga këto të dhëna bëhet e qartë nevoja për fuqizimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, lidhur me ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike, vetëdijesimin e të rinjve dhe familjeve lidhur me dëmet që shkakton ekspozimi në tymin e duhanit dhe përkrahjen e projekteve dhe fushatave ndërgjegjësuese lidhur me rëndësinë e kontrollit të reklamimit dhe shitjes së duhanit. Në fund, lidhur me njohurit dhe qëndrimet 77.9% e nxënësve mendojnë e duhani është i dëmshëm për njerëzit që përdorin duhan, kurse 94.3% favorizojnë ndalimin e pirjes së duhanit brenda vendeve publike të mbyllura.

Kur jemi tek shëndeti riprodhues, hulumtimet tregojnë se vetëm 46.2 për qind e të rinjve konfirmojnë se nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale. Natyrisht, personat 25–29 vjeç kanë më shumë përvojë seksuale, krahasuar me të rinjtë në vitet e adoleshencës. Përvoja seksuale është më mbizotëruese tek meshkujt sesa femrat. Për më tepër, aktiviteti seksual lidhet me rezultatin e indeksit të pasurisë, pasi rinia që i korrespondon familjeve në një gjendje më të mirë ekonomike priren të deklarojnë më shumë për një sjellje të tillë.

Kontraktivët përdoren nga 40 për qind e të rinjve që kanë pasur eksperiencë seksuale. Katër për qind e të rinjve nuk janë të informuar mbi këto çështje. Ekziston një lidhje statistikisht shumë e rëndësishme ndërmjet atyre që pinë alkool dhe të rinjve që përdorin kontraktivë. Për më tepër, ata që janë në rezultatin e indeksit të pasurisë si “të pasur” dhe kanë përfunduar nivele të larta të arsimit janë më të prirur për të përdorur kontraktivë. Meshkujt janë të mësuar me kontraktivët, ndërsa rezidenca urbane apo rurale nuk jep ndonjë dallim statistikor lidhur me këtë.

---

<sup>6</sup> Youth Study Kosovo 2018/2019, The Friedrich-Erbert-Stiftung/FES

### *3.2 Rritja e sigurisë së rinisë*

Analizat dhe raportet e fundit tregojnë se ka një rritje të dukshme të rrezikimit të sigurisë së të rinjve në Kosovë por edhe vendet tjera. Të rinjtë janë të ekspozuar mjaft ndieshëm ndaj dukurive të ndryshme negative si dhuna, pasiguria sociale, rrymat e ndryshme ideologjike fetare apo edhe politike e kështu me radhë. Poashtu, në kohën e tashme, bota ka filluar të kupton se të rinjtë nuk janë vetëm pjesë e problemit. Të rinjtë sot kanë një rol shumë më të rëndësishëm. Të rinjtë janë edhe kontribuesit më të mëdhenjë të sigurisë dhe paqes në të gjitha vendet ku ka pasur konflikte e lufta. Duke pasur parasysh këtë, Kombet e Bashkuara kanë miratuar Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 2250 (2015) ku ka njohur kontributin pozitivë që japin të rinjtë në ruajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë në botë.

Gjithashtu, Bashkimi Evropian, përmes Strategjisë për Rini 2019-2027, synon përmirësimin e gjithëpërfshirjes shoqërore të të rinjëve, mirëqenien sociale si dhe dialogun e hapur dhe konstruktivë. Të gjitha këto, me qëllim të rritjes sa më të madhe të sigurisë personale, ekonomike e sociale të rinisë në vendet e BE-së dhe vendeve fqinje të BE-së.

Kosova ka shënuar raste mjaft të rënda penale dhe delikuate ku të rinjtë kanë qenë të përfshirë si pjesëmarrës si vjedhje, rrahje, kontrabandë, trafikim, etj. Ky fakt mbetet shumë shqetësuese për departamentin e rinisë dhe duhet me prioritet për të punuar më shumë në parandalimin e tyre. Sfiduese për departamentin e rinisë janë institucionet e shkollës dhe universitare ku numër shumë i madh i të rinjve vijon shkollimin, ku këto institucione punojnë fare pak me të rinjtë në fushën e sigurisë së të rinjëve në çfarëdo forme qoftë ajo. Mungesa e ofrimit të aktiviteteve në fushën e sigurisë njerëzore në institucionet shkollore paraqet një rast mjaft të mirë të humbur për të prekur këta të rinjtë me programe vetëdijësimi dhe aftësimi për të trajtuar me sukses rreziqet që iu kanosen të rinjve gjatë rrugëtimit të tyre përgjatë jetës si në aspektin profesional ashtu edhe personal.

### *3.3 Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative*

Të rinjtë e Kosovës ende janë duke vuajtur nga pasojat e luftës së fundit. Grupet e marginalizuara mbeten ende shumë larg përfitimit të mbështetjes së nevojshme për të realizuar të drejtat e tyre. Në shumë raporte, shqetësimet më të mëdha kanë të bëjnë lidhur me mungesën e integritimit të grupeve të ndryshme të rinisë në jetën shoqërore e kulturore. Grupet etnike në Kosovë për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive mbeten sfidë në integrimin e tyre në jetën shoqërore e kulturore të Kosovës. Gjithashtu, grupet e ndryshme të të rinjve me aftësi të kufizuar kanë përpara sfida serioze në realizimin e të drejtave themelore të tyre.

Në Kosovë të rinjtë e komuniteteve të ndryshme sot kanë vështirësi për të komunikuar ndërmjet vete për arsye se nuk dijnë gjuhën e tjetrit. Paragjykimet dhe stereotipet në Kosovë vazhdojnë të afektojnë negativisht hapjen e dialogut të mirëfilltë ndërmjet të të rinjëve të komuniteteve të ndryshme.

Promovimi dhe mbështetja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është shumë e rëndësishme për arritjen e progresit në Kosovë për gjithëpërfshirje të këtyre grupeve shumë të ndjeshme.

Studime dhe raporte të ndryshme rekomandojnë se aktivitetet kulturore dhe sportive janë mjete shumë të efektshme për integrimin e të rinjve në jetën shoqërore. Janë mekanizma tepër të dobishëm në luftimin e paragjytimeve, hapjen e komunikimit ndërmjet të rinjëve por edhe si mjete shumë të mira për të mësuar kulturat e ndryshme si dhe rekreacion të të rinjve në kohën e tyre të lirë.

## VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për Rininë 2019 - 2023 synon që të rinjtë në Republikën e Kosovës të jenë qytetarë aktivë, të përgjegjshëm, të shëndetshëm, të sigurtë, të arsimuar dhe të edukuar, të cilët jetojnë jetë të dinjitetshme dhe cilësore, të përgatitur dhe aktivë të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë llogaridhëse dhe të përgjegjshme.

Objektivat strategjike përfshijnë si në vijim:

Objektiva strategjike 1: Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive

Objektiva strategjike 2: Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës

Objektiva strategjike 3: Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

Qasja analitike e të dhënave si dhe krahasimet e bëra në rrafshin hulumtues mundësojnë qartë definimin e problemeve, të objektivave, masave dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren. Bazuar në politikat ndër-sektoriale dhe specifike që udhëheq MKRS, është bërë edhe përcaktimi për trajtim të tillë të sektorit të rinisë dhe është në përputhje me programet dhe aktivitetet e kësaj ministrie.

## **MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË**

### *Roli i sistemit të monitorimit*

Strategjia për Rini 2019-2023 ka edhe planin e vet të veprimit i cili përbëhet nga objektivat strategjike, masat dhe aktivitetet, përgjegjësit dhe kostoja financiare për zbatim. Plani i veprimit të strategjisë rishikohet në baza vjeçare në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji.

Procesi i zbatimit të strategjisë do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike dhe i masave të saj. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga DiR.

Monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë dhe i planit të veprimit është pjesë përbërëse e detyrave dhe përgjegjësi të divizioneve në kuadër të DiR. Procesi i vlerësimit do të shoqërohet edhe me ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zyrtarët për monitorim të cilët do të jenë pjesë e realizimit të kësaj Strategjie.

### **Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë**

Rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur përparimin e arritjes së objektivave strategjike, masave dhe aktiviteteve. Pasi të hartohen raportet e të arriturave, bazuar mbi të dhënat dhe vërtetimet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë: 1) Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale; 2) Organizatat Rinore; 3) Partnerët ndërkombëtarë, 4) Media, 5) Publiku i gjerë.

Publikimi i rezultateve do të bëhet nëpërmjet medias ose duke organizuar tryeza diskutimi, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë, duke i angazhuar në mënyrë të veçantë Organizatat Rinore.

Si bartës dhe përgjegjës kryesor për realizimin e objektivave, DiR do t'i monitorojë treguesit që kanë të bëjnë me implementimin e strategjisë. Në fund të çdo viti, DiR përgatit raportin e të arriturave për shkallën e realizimit të objektivave, të cilin e publikon dhe e bën të njohur për të gjitha palët e interesit.

### *Shqyrtimi afatmesëm i Strategjisë*

Objektivat strategjike kanë për qëllim përparimin e rolit të rinjve në shoqërinë kosovare, barazinë në trajtimin e të gjithë të rinjve dhe përparimin e çështjeve rinore në fusha të ndryshme të jetës së tyre. Strategjia do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe vlerësim përfundimtar. Në këtë mënyrë së bashku me raportin e të arriturave, në secilin fillim vit, DiR do të ndërmerr një proces të rishikimit të objektivave dhe treguesve.

## Kontrolli dhe mbikqyrja e dhënies së granteve

Me qëllim të përmbushjes së objektivitetit strategjisë, një pjesë e fondeve planifikohet t'u shpërndahet Organizatave Rinore, të cilat shtrijnë ndikimin e gjerë në komunitetin rinor. Për të qenë llogaridhënës dhe transparent, DiR duhet zhvilluar standard minimale dhe kriteret të përcaktuara qartë se cilat Organizat Rinore mund të jenë përfitues të fondeve, si dhe t'i përmbahet standardeve të rregullores së Qeverisë së Kosovës për financimin e OJQ-ve. Këto kriteret shërbejnë për vlerësimin e aplikacioneve të Organizatave Rinore, të cilat duhen publikuar në raport përmbledhës.

Gjithashtu DiR duhet që të zhvillojë kornizën për monitorim dhe vlerësim të realizimit të projekteve të Organizatave Rinore, si dhe të raportimit të arritjes së rezultateve të projekteve të cilat mbështeten me fondet e MKRS/DiR. Ndërtimi i sistemit të monitorimit dhe të vlerësimit të arritshmërisë së qëllimeve të projekteve të realizuara nga Organizatat Rinore është më se i domosdoshëm, sepse përcakton përkrahjen e mëtutjeshme të organizatave të tilla nga fondet e MKRS/DiR. Sistemi i tillë i monitorimit dhe i vlerësimit duhet të jetë në gjendje të prodhojë raporte mbi arritshmërinë, llogaridhënien dhe transparencën e realizimit të projekteve, në të cilat duhet të ketë qasje publiku.

Këto të dhëna theksojnë nevojën e përkrahjes së projekteve nga të cilët të rinjtë do të marrin informata të sigurta, për arsye se të rinjtë nuk kanë besim në informacionin që e marrin nga interneti, edhe pse ai është burimi kryesor i informatave.

## NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve pesë vjeçare të Strategjisë për Rini 2019 - 2023 ka një shumë totale të zbatimit prej 11.661.900 Euro.

Objektivi strategjik	Buxheti					
	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive	€938,500	€1,275,000	€1,266,500	€1,266,500	€1,266,500	€6,013,000
Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës	€334,500	€635,000	€665,000	€695,000	€725,000	€3,054,500
Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë	€319,400	€555,000	€560,000	€580,000	€580,000	€2,594,400
	<b>€1,592,400</b>	<b>€2,465,000</b>	<b>€2,491,500</b>	<b>€2,541,500</b>	<b>€2,571,500</b>	<b>€11,661,900</b>

## Burimet e financimit të Strategjisë

Financimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Rini 2019-2023 parashihet të bëhet nga MKRS/DiR dhe agjencitë zhvillimore.

### 1. Rini e mobilizuar për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive

#### 1.1 Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Organizatave Rinore

##### 1.1.1 Ngritja e kapaciteteve për Organizatat Rinore lidhur me zhvillimin organizativ

Lëvizjet e shpeshta të drejtuesve të organizatave rinore dhe të stafit tjetër rinor paraqesin nevojën e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve në kontekstin e zhvillimit organizativ. Është interes i shoqërisë që të ketë Organizata Rinore të strukturuar dhe të organizuara mirë. Andaj ngritja e kapaciteteve për Organizatat Rinore në kontekstin e zhvillimit organizativ shihet si një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili është paraparë që të organizohet nga vet DiR përmes shërbimeve të konsulencës dhe burimeve vetanake, varësisht nga modulet trajnuese të nevojshme. Fillimisht do të bëhet një vlerësim i gjendjes aktuale në aspektin e zhvillimit organizativ të organizatave rinore në tërë Republikën e Kosovës, përfshirë konsultimin me raportet e deritashme nga hulumtimet e agjencive zhvillimore dhe të organizatave të tjera. Vlerësimi kryhet përmes bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha palët e interes që në programet e veta kanë për synim rininë. Nga analiza e të gjeturave prioritizohen pakot adekuate të trajnimeve të cilat më pas zbatohen nga ofruesit e shërbimeve të trajnimeve.

##### 1.1.2 Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve rinorë komunalë

Është nevojë e menjëhershme që DiR të ketë një urë ndërlidhëse në secilën komunë, respektivisht zyrtarë rinorë komunalë, me të cilët koordinon veprimet lidhur me rininë, dhe të cilët duhen të jenë në një vijë me politikën shtetërore për rininë. Zhvillimet e vazhdueshme nëpër administratat lokale paraqesin nevojën për përkrahjen e vazhdueshme për ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve rinorë komunalë. Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve rinorë komunalë planifikohet të kryhet pas një hulumtimi për vlerësimin e nevojave. Përgjegjës për këtë masë do të jetë DiR i cili përmes angazhimit të shërbimeve të konsulencës profesionale do të adresojë kapacitetet e zyrtarëve rinorë komunalë.

##### 1.1.3 Përkrahja e nismave që mundësojnë krijimin e rrjeteve formale dhe joformale (ndarja e mjeteve financiare, deri në 10 mijë euro në vit - jo më shumë se 3 rrjete në vit)

Rrjetëzimet janë segment tejet i veçantë dhe i rëndësishëm për zhvillimin dhe promovimin e organizatave rinore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrojnë një mobilitet rinor më të madh. Ato ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave të sukseshme dhe të njohurive ndërmjet të rinjve, promovojnë punën e tyre në nivele vendore dhe ndërkombëtare. Andaj si të tilla, është

planifikuar që të përkrahen nismat e kësaj natyre. Me këtë aktivitet synohet që të përkrahen për formalizim edhe rrjetet eventuale joformale të cilat janë të suksesshme dhe arrijnë mobilitet të rinjve në shkallë të gjerë.

#### *1.1.4 Mbështetja e projekteve ose nismave për aktivizimin rinor në komunitet / mobilitetin rinor*

Aktivizimi rinor është një komponentë shumë e rëndësishme e zhvillimit të përgjithshëm rinor dhe i ndihmon të rinjtë që nga moshën 15 vjeçare të zhvillojnë ndjenjat dhe përgjegjësitë për mjedisin ku jeton dhe si sillet një i ri. Gjithashtu në këtë fazë pritet që rinia të kuptojë dhe zbatojë format e ndryshme të vet-organizimit me qëllim të adresimit të çështjeve që lidhen me jetën rinore. Është planifikuar që DiR të mbështesë me grante nismat e Organizatave Rinore të cilat nxisin aktivizimin rinor nëpër gjithë territorin e vendit. MKRS në përputhje me marrëveshjen me ZRBR por edhe me mekanizmat tjerë të interesuara të kontribuojnë mobilitetin rinor ofron mbështetje për mobilitet rajonal të rinjve.

#### *1.1.5 Përkrahja e Organizatave Rinore përmes sigurimit të kontributit/pjesëmarrjes gjatë aplikimit në fondet e agjencive zhvillimore dhe programeve të tyre*

Njëra ndër sfidat e vazhdueshme e cila po i përcjellë organizatat rinore në Kosovë është vështërsia e sigurimit të mjeteve financiare si kusht për kontributin financiar gjatë procesit të aplikimit për fonde të BE-së dhe agjencioneve të tjera zhvillimore. Një pjesë e madhe e agjencive zhvillimore/donatorëve, me qëllim të sigurimit të përkushtimit, kërkojnë bashkëpjesëmarrje në përqindje të caktuar të shumës së përgjithshme të projektit. Për të lehtësuar këtë proces DiR do të mbështesë Organizatat Rinore kosovare të cilat aplikojnë në fondet e tilla të agjencive zhvillimore/donatorëve.

#### *1.1.6 Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërgjegjësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve*

Fusha e të drejtave dhe përgjegjësi të njeriut konsiderohet të jetë ndër më të rëndësishmet për të pasur një shoqëri të përgjegjshme dhe të respektit ndaj njëri-tjetrit pavarësisht dallimeve. Për këtë qëllim është planifikuar që DiR të mbështesë Organizatat Rinore të cilat promovojnë dhe ndërgjegjësojnë të rinjtë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri. Përzgjedhja e përfituesve nga DiR bëhet duke u bazuar në kriteret dhe standardet e hartuara paraprakisht, në përputhje me legjislacionin për subvencione në fuqi.

## **1.2 Konsolidimi i legjislacionit për rininë**

### *1.2.1 Promovimi i mekanizmave ligjorë për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje*



DiR është promovues dhe përfaqësues i rinisë në Kosovë, gjersa një pjesë e barës i mbetet të përkujdeset që politikat rinore të jenë adekuate, në harmoni me nevojat e të rinjve, konform legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, dhe që ofrojnë mobilitet të vazhdueshmëm rinor. Promovimi i politikave dhe legjislacionit rinor përkujton të gjithë vendim marrësit e të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të institucioneve relevante që të kenë rininë në përqendrim, duke u ofruar atyre mundësinë dhe parakushtet të shprehin vetveten dhe të pozicionohen sa më mirë në shoqërinë kosovare. Përmes medimeve audio vizuale dhe platformave elektronike, DiR promovon vazhdueshëm mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje të rinisë.

### *1.2.2 Realizimi i hulumtimeve lidhur me gjendjen e sektorit të rinisë dhe monitorimi i rregullt i zbatueshmërisë së legjislacionit lidhur me pjesëmarrjen*

Për të identifikuar gjendjen aktuale të sektorit të rinisë në Kosovë, respektivisht nevojat, shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre, DiR vazhdimisht planifikohet të realizojë hulumtime të ndryshme, rezultatet e së cilave duhen përdorur për përplotësim të legjislacionit sekondar ose primar. Hulumtimet e tilla kryhen nga DiR ose nga konsulentët e angazhuar si shërbim profesional. Gjithashtu DiR do të hartojë një kornizë të monitorimit dhe të vlerësimit të zbatueshmërisë së legjislacionit sekondar dhe primar për rininë, me qëllim që të kujdesen të kryhen obligimet e vendim marrësve të shprehura në legjislacion. Raportet e monitorimeve përfshirë rekomandimet, përveç që publikohen, dorëzohen në kabinetin e ministrit, i cili më pas i dorëzon te vendim marrësit gjegjë.

### *1.2.3 Krijimi i platformës digjitale për legjislacionin primar, sekondar, nismat ligjore, politikat rinore, strategjitë lokale dhe planet e veprimit në shërbim të të gjitha organizatave rinore*

DiR do të krijojë dhe mirëmbajë një platformë elektronike ku do të jetë i vendosur i tërë legjislacioni primar, sekondar, nismat ligjore, politikat rinore, strategjitë lokale dhe planet lokale të veprimit për rini në shërbim të të gjitha organizatave rinore në vend. Platforma do të përmbajë edhe informacion për mundësinë e aplikimit për grante, si dhe vegza të tjera të cilat i ndihmojnë organizatat rinore për të komunikuar me institucionet, organizatat, rrjetet, agjencitë zhvillimore dhe nismat e ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Platforma e këtillë synohet t'i ndihmojë jo vetëm të rinjve si individë, por edhe të gjitha grupeve joformale që mëtojnë të arrijnë ndryshime pozitive në botën e të rinjve.

## **1.3 Përkrahja për mobilitetin rinor**

### *1.3.1 Ndërgjegjësimi i komunitetit rinor për pjesëmarrje dhe qytetari aktive*

Aktivizmi qytetar që nga mosha e hershme rinore është një komponentë mjaft e rëndësishme e zhvillimit dhe të socializimit të hershëm të të rinjve. Për të ndërgjegjësuar dhe ofruar

informacion të bollshëm lidhur me pjesëmarrje dhe qytetari active, DiR do të organizojë ngjarje të ndryshme publike, të paraqitura përmes medimeve elektronike dhe audio vizuale.

### *1.3.2 Ofrimi i mbështetjes për ndërtimin dhe rehabilitimin e qendrave rinore, përfshirë ndërtimin dhe rehabilitimin terreneve rekreative dhe sportive për zhvillim të aktiviteteve sociale të të rinjve*

Zhvillimi i mirëfilltë fizik dhe social rinor në vend nuk mund të paramendohet pa infrastrukturën adekuate fizike përcjellëse, sikurse që janë Qendrat Rinore dhe terrenet rekreative dhe sportive. Meqenëse janë komunat ato që ofrojnë infrastrukturën e tillë, DiR ofron mundësinë e ndihmës financiare në formë të bashkë pjesëmarrjes për ndërtimin e infrastrukturës së cekur komunave të cilat janë në pamundësi për të ofruar si të vetme një mundësi të tillë. Komunat përfituese do të përzgjidhen sipas kriterëve dhe standardeve të hartuara paraprakisht nga DiR. Gjithashtu, përmes përfshirjes edhe të agjencive zhvillimore, DiR do të hulumtojë, sigurojë dhe ndërmjetësojë në gjetjen e fondeve për mbështetje në ndërtimin e infrastrukturës fizike rinore në gjithë vendin.

### *1.3.3 Inventarizimi, përditësimi dhe katalogizimi i shërbimeve të Organizatave Rinore që ofrohen për të rinjtë*

Që nga paslufta, numri i Organizatave Rinore është në vazhdimësi duke u shtuar. Një pjesë e madhe e tyre janë shuar, gjersa një pjesë e vogël e tyre kanë mbijetuar, dhe tashmë qëndrojnë si organizata të strukturuar, të profilizuara, me përvojë dhe kompetencë të fituar. Organizatat e këtyra vazhdojnë të ofrojnë një numër të caktuar të shërbimeve që janë në hap me kohën, nga të cilat përfitojnë me mijëra të rinj. Në anën tjetër, DiR sfidohet nga mungesa e informacionit për të gjitha shërbimet dhe cilësitë e atyre shërbimeve, që ofrohen nga organizata të shumta rinore. Andaj është shtruar nevoja që të përmbledhen dhe katalogizohen të gjitha shërbimet që ofrohen për të rinjtë, përfshirë edhe ofruesit e atyre shërbimeve, gjegjësisht Organizatat Rinore, përfshirë programet rinore të përkrahura nga agjencitë zhvillimore. Informacioni i këtyre shërbimeve DiR që të ketë njohuri mbi shërbimet që ofrohen për të rinjtë, dhe me shpërndarjen e informacionit të tillë DiR pasuron ofertën e shërbimeve në të gjitha komunat ku nuk ka pasur shërbim të tillë gjersa nevoja për to është në rritje. Informacioni i tillë planifikohet të shpërndahet përmes medimeve elektronike.

### *1.3.4 Ndarja e fondit të veçantë për mobilitetin rinor*

I krijuar drejtpërdrejtë nga ministri i MKRS, dhe më tutje me mundësi të rritjes nga agjencitë zhvillimore, fondi prej të paktën 200.000 Euro synon të rritë mobilitetin rinor duke përkrahur aktivitetet që kanë për qëllim: 1) Rritjen e bashkëpunimit me organizatat dhe institucionet rinore ndërkombëtare si rrjetëzimet, shkëmbimet, vizitat studimore, prezantimet e të arriturave, kampet, etj. Këto praktikat moderne të zhvillimit rinor në vend mund të arrihen

duke e ndërtuar dhe zgjeruar edhe më tej bashkëpunimin me organizatat, rrjetet dhe institucionet ndërkombëtare që punojnë ose përkrahin sektorin e rinisë; 2) Përkrahjen e Organizatave Rinore që merren me sfidat e të rinjve lidhur me cilësinë në arsim dhe dukuritë që pengojnë arsimin cilësor, si dhe me rrethanat e mundësitë që u ofrohen të rinjve në arsim. Megjithatë ekziston hapësirë e mjaftueshme të intervenimit në këtë sektor nga ana e Organizatave Rinore dhe palëve të tjera të interesit; 3) Përkrahjen e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërmjetësojnë / ndërgjegjësojnë për pozitën e vështirë të grupeve rinore të marginalizuara dhe në nevojë. Kjo ngase kohëve të fundit është treguar se mjaft prej Organizatave Rinore punojnë drejt përmirësimit të pozitës së grupeve të marginalizuara dhe në nevojë, sidomos të rinisë së kufizuar për të pasur një jetë të dinjitetshme, gjithnjë duke u bazuar në të drejtën njerëzore; dhe 4) Përkrahjen e nismave dhe Organizatave Rinore jashtë kufinjve të Republikës së Kosovës me qëllim të promovimit kulturor, të identitetit, të vlerave që përfaqësojnë vendin, dhe të qytetarisë aktive përmes mobilizimit rinor. Kjo ngase vendi ynë ka nevojë të fuqizojë lidhjet e rinisë së vendit me atë nga diaspora, gjithashtu edhe rinia e diasporës ka nevojë të bashkëpunojë me rininë në vend, ashtu që t'i ofrojnë njëri-tjetrit mundësi të shumta jo vetëm të pasurimit të jetës sociale dhe të ruajtjes së identitetit kulturor, por edhe të mundësive për arsim të mëtutjeshëm dhe kyçje në tregun e punës. Gjithashtu është edhe në interes të shtetit të ruhen dhe të zhvillohen lidhjet mes bashkëmoshatarëve brenda dhe jashtë vendit.

## **1.4 Zhvillimi i vullnetarizmit**

### *1.4.1 Promovimi i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare*

Vullnetarizmi nënkupton aktivitetet që zhvillohen nga personat fizikë të moshës 15-24 vjeçare që ofrojnë kohën, punën, njohuritë, dhe aftësitë e tyre në shërbim të komunitetit për të mirën e shoqërisë pa pagë. Gjithsesi që vullnetarizmi është një satisfakcion për secilin të ri i cili i kontribuon zhvillimit dhe mirëqenies së komunitetit të tij, andaj si i tillë ai ka nevojë për t'u promovuar në mesin e të rinjve përmes aktiviteteve ndërgjegjësuëse. Kësisoj DiR këtë veprim do ta zbatojnë përmes ndërmarrjes së veprimeve promovuese të vullnetarizmit dhe të punës vullnetare. Këtë mendohet të arrijë përmes medimeve audio vizuale, vizitave në terren nëpër Organizata Rinore në të gjitha komunat e vendit, në debate, tryeza e konferenca, si dhe në platformat elektronike, duke mos përjashtuar edhe aktivitete të tjera.

### *1.4.2 Menaxhimi i procesit të punës vullnetare*

Është planifikuar që puna vullnetare të njihet institucionalisht dhe të kreditohet me orë pune përmes platformës dhe databazës elektronike ekzistuese për vullnetarë (PDV) pranë MKRS. Puna vullnetare është menduar të menaxhohet nga DiR, gjersa janë Organizatat Vullnetare, institucionet dhe të gjitha subjektet tjera juridike janë të obliguara që përmes sistemit

elektronik (PDV) të regjistrohen dhe të regjistrojnë orët e punës vullnetare të përfunduara, duke njohur njëkohësisht statusin e të riut vullnetar dhe përvojën e punës vullnetare.

Udhëzimi Administrativ për punë vullnetare specifikon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e vullnetarit dhe ofruesit të punës vullnetare përmes kriterëve me DiR në bashkërendim të veprimeve me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe vet Organizatat Rinore, do të hartojë Udhëzim Administrativ/UA të specifikuar për punën vullnetare dhe mënyrën e njohjes së saj. UA planifikohet të jetë përshkrues, të përfshijë kriteret dhe standardet për licencimin e Organizatave Rinore për punë vullnetare dhe për certifikim të punës vullnetare, me qëllim të shmangët mundësia e keqmenaxhimit të këtij procesi. Gjithashtu DiR, përmes PDV, do të ofrojë informacion të bollshëm për procesin e licensimit, certifikimit dhe të monitorimit lidhur me punën vullnetare.

#### *1.4.3 Njohje e punës vullnetare të të rinjve nga DiR të cilët rekomandohen nga organizatat rinore që ofrojnë punë vullnetare*

Në përplotësim të politikave dhe propozim politikave aktuale shtetërore lidhur me vullnetarizmin, puna vullnetare dhe vullnetarizmi në përgjithësi duhet të rregullohet edhe më tutje, në mënyrë që kontributi vullnetar të vazhdojë të njihet dhe të vlerësohet institucionalisht. Njohja e punës vullnetare është shtytës i rëndësishëm për ofrimin e punës vullnetare nga të rinjtë, andaj DiR do të vazhdojë certifikimin/njohjen e punës vullnetare, të shprehura në orë pune.

#### *1.4.4 Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë vullnetarizmin dhe punën vullnetare*

Meqenëse vullnetarizmi është, përveç satisfacionit, edhe një motiv shtytës për secilin të ri që t'i kontribuojë zhvillimit dhe mirëqenies së komunitetit të tij, andaj dhe DiR në bashkëpunim me zyrën e UNICEF-it në Kosovë, por edhe me të gjitha agjencitë zhvillimore të tjera të interesuara të kontribuojnë në këtë drejtim, do të përkrahë Organizatat Rinore në Kosovë të zbatojnë aktivitete dhe projekte me qëllim të promovimit të vullnetarizmit dhe të punës vullnetare në komunitet.

## **2. Rini e shkathtësuar dhe përgatitur për treg të punës**

### **2.1 Zhvillimi i edukimit jo formal <sup>7</sup>**

#### *2.1.1 Organizimi i ngjarjeve që çojnë drejt edukimit jo formal*

Organizimi dhe mbështetja e ngjarjeve me qëllim aftësimin e të rinjve përmes edukimit jo formal.

Edukimi jo formal është një edukim tërësor, që hap sytë dhe mendjen e të rinjve ndaj realiteteve të botës dhe i zgjon ata për një botë me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta njerëzore për të gjithë. Realizimi i programeve alternative të edukimit synon avansimin në të kuptuarit e shoqërisë nga të rinjtë rreth temave politike, sociale, filozofike, koncepteve shkencore dhe analizës së proceseve shoqërore. Objektivi i Strategjisë në lidhje me edukimin jo formal është të zhvillojë, të rrisë dhe të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve tek të rinjtë për edukim, duke ju referuar proceseve të edukimit personal dhe social, të dizajnuara të përmirësojnë një varg të shkathtësive, kompetencave dhe kultivimin e vlerave duke ndërtuar qëndrime për qytetari të përgjegjshme, tolerante dhe ndërvepruese jashtë kurrikulës së edukimit formal. Kjo masë në mënyrë specifike ka të bëjë me avansimin e mendimit kritik, përkrahjen në organizimin e trajnimeve për teknikat debatuuese, organizimin e aktiviteteve që krijon mundësi dhe hapsirë për të rinj nga Kosova dhe Diaspora, TEDx, organizimin e tryezave të rrumbullakëta, konferencave, kampeve, punëtorive, diskutimeve të hapura, organizimin e aktiviteteve për ngritjen e shkathtësive e të folurit në publik, edukimin financiar, leadershipin dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme që përfshirjnë komunitet.

#### *2.1.2 Organizimi i ngjarjeve rinore për promovimin e edukimit jo formal*

Ndërmjetësi më i mirë në promovimin e edukimit jo formal konsiderohen të jenë Organizatat Rinore. DiR do t'i mbështesë Organizatat Rinore me qëllim që ato të ndërgjegjësojnë të rinjtë dhe të promovojnë edukimin jo formal në bashkësitë e tyre ku jetojnë. Për arsye të rëndësishme të madhe që e ka edukimi jo formal, DiR do të organizojë ngjarje promovuese dhe të ndërmerr aktivitete të cilat e promovojnë këtë fushë. Aktivitetet e parapara: Realizimi I Audio-videoreklamës, hartimi, shtypja dhe shpërndarja e materialeve promovuese, vizitë shkollave për rolin e Edukimit jo formal në ndërtimin e karrierës, Organizimi I takimeve me sektorin publik dhe privat, Panairë të Edukimit dhe Konferenca për promovimin dhe nxitjen e të rinjve për pjesëmarrje në edukim jo-formal.

---

<sup>7</sup> Ligji Nr. 04/L-143 Për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës: Mësimi që rezulton nga aktivitetet ditore të lidhura me punën, familjen ose kohën e lirë. Nuk është i autorizuar ose strukturuar në aspektin e qëllimeve, kohës ose përkrahjes mësimore. Në shumicën e rasteve, mësimi informal është i paqëllimshëm nga perspektiva e kandidatit. Rezultatet mësimore informale zakonisht nuk shpijnë në certifikim por mund të validohen dhe certifikohen në kuadër të skemës së njohjes së mësimin paraprak. Mësimi informal referohet edhe si mësim praktik (eksperimental), plotësues apo i rastësishëm.

## **2.2 Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës**

Përveç masave të planifikuara me këtë dokument strategjik, me qëllim të sinkronizimit të politikave rinore të punësimit dhe të vet-punësimit, DiR udhëzohet të ndërmer veprime të cilat janë të planifikuara edhe në dokumentin strategjik ndërsektoral të MPMS “Plani i veprimit: rritja e punësimit të të rinjve 2018-2020”.

### *2.2.1 Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës*

Meqenëse veprimet që lidhen drejtpërdrejtë me orientimin në karrierë tashmë janë planifikuar nga sektorët apo departamentet tjera përgjegjëse kryesisht të MAShT, me këtë masë DiR kontribuon në promovimin dhe ndërgjegjësimin për orientimin në karrierë. Gjithashtu kjo masë i prekë të gjithë ata të rinj që për ndonjë arsye apo tjetër nuk janë të përfshirë në arsimin formal, meqë orientimi në karrierë të paktën e minimizon mundësinë e dështimit të punësimit të planifikuar. Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës planifikohet të jetë një aktivitet i vazhdueshëm i institucioneve relevante, i cili duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë. DiR do të promovojë dhe ndërgjegjësojë për idenë e orientimit në karrierë dhe treg adekuat të punës si e vetme apo përmes ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta me ndihmën e Organizatave Rinore dhe të komunitetit të biznesit.

### *2.2.2 Organizimi dhe përkrahja e panairove për informimin e të rinjve mbi rëndësinë dhe nxitjen e tyre për kyçje në tregun e punës*

Ndarja e informacionit ndërmjet të gjitha palëve të interesit në fushën e punësimit, vetë punësimit dhe të tregut të punës në Kosovë është një domosdoshmëri e pashmangshme për t'i arritur efektet e dëshiruara në rritjen e punësueshmërisë sidomos tek gjenerata e reja. Këto ngjarje të rëndësishme, tani më si praktika të sukseshme e të sprovuara në vendet e zhvilluara, ofrojnë mundësi të shumta për shkëmbime informacionesh lidhur me punësueshmërinë në vend. DiR në bashkëpunim me Organizatat Rinore dhe me komunitetin e biznesit planifikon të organizojë panairove për informimin e të rinjve mbi rëndësinë dhe nxitjen e tyre për kyçje në tregun e punës. Gjithashtu ndërgjegjësohet komuniteti i biznesit lidhur me potencialin rinor të shkathtësuar që mund të angazhojë në tregun e punës. Për këtë qëllim DiR planifikon të organizojë apo përkrahë të paktën tri panairove në vit.

### *2.2.3 Përcaktimi i prioriteteve dhe i deficiteve në tregun e punës përmes hulumtimeve të vazhdueshme*

Punësueshmëria në vend lidhet kryesisht me shërbimet dhe ndërmarrjet e vogla të mesme, ku dhe shihet potenciali për kyçje në treg të punës. Ky potencial gjatë gjithë kohës duhet të hulumtohet, ku informacioni për mundësitë e kyçjes në treg të punës duhet të jetë me kohë i ofruar tek të rinjtë. Për këtë qëllim planifikohet të organizohen hulumtime të vazhdueshme, si veprime të domosdoshme në përcaktimin e saktë të prioriteteve dhe të deficiteve në tregun e punës në Kosovë. DiR do të angazhojë shërbime konsulence profesionale që do të kryejnë hulumtime të duhura për të vlerësuar gjendjen aktuale dhe të definimit të nevojave dhe prioriteteve lidhur me tregun e punës, e të cilat ndërlidhen me të rinjtë. Rezultatet dhe rekomandimet nga hulumtimet e tilla profesionale jo vetëm që do të shërbejnë për hartimin e programeve nacionale të cilat e përmirësojnë punësueshmërinë tek të rinjtë kosovarë, por informacioni i tillë do t'i ofrohet drejtpërdrejt edhe të rinjve me çka rriten mundësitë për kyçjen e tyre në tregun e punës.

### *2.2.4 Hartimi i kriterëve dhe i standardeve për përkrahjen për ndërmarrësitë rinore, dhe i udhërrëfyesve për ndërmarrësitë që kanë synim rininë*

Meqenëse në vend shumë agjenci zhvillimore zhvillojnë dhe zbatojnë programe që përkrahin të rinjtë, shpesh të pa koordinuara njëra me tjetrën, është shtruar nevoja e menjëhershme që të krijohet një politikë që përcakton kriteret dhe standardet për përkrahje në ndërmarrësi. Këto duhen të bazohen në hulumtime dhe analiza të thella të treguesve ekonomikë. Për këtë qëllim DiR do të facilitojë procesin e hartimit të kriterëve dhe standardeve për përkrahjen për ndërmarrësitë rinore në Kosovë, dhe të zhvillojë udhërrëfyes për programet e ndërmarrësisë që kanë për synim rininë. DiR do të angazhojë konsulencë profesionale që pritet të zhvillojë kriteret dhe standardet në formë të udhërrëfyesit për ndërmarrësinë rinore, gjithashtu duke u bazuar edhe në praktikat më të mira nga vendet e rajonit dhe evropiane, duke përfshirë edhe specifikat lokale. Ky veprim, njëherë i përfunduar, dukshëm do t'i kontribuojë koordinimit të të gjitha veprimeve që ndërmerren si nga agjencitë zhvillimore ashtu edhe nga sektorët qeveritarë.

### *2.2.5 Themelimi i trupi koordinues për përkrahjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë me përfshirje të gjerë të hisedarëve shtetërorë dhe agjencive zhvillimore*

Ndërmarrësia tek të rinjtë është masë që duhet mbështetur fuqimisht nga të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë, sepse drejtpërdrejt i kontribuon zvogëlimit të papunësisë së të rinjve. Për të qenë veprimet e tilla të koordinuara mire, është shtruar nevoja themelimi i një trupi koordinues me përbërje të gjerë nga të gjitha palët e interes që lidhen me sferën e zhvillimit të ndërmarrësisë në Kosovë. Në mënyrë që sukseset të mos jenë të fragmentuara ose të pjesërishme, gjithsesi agjencitë zhvillimore duhen koordinuar si në planifikimin, ashtu edhe në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të

ndërmarrësisë. Për këtë qëllim DiR planifikon të themelojë trupin koordinues për përkrahjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë, me përfshirje të gjerë të hisedarëve shtetërorë dhe të agjencive zhvillimore. Ky trup koordinues do të mbledh rreth tij përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale, odat ekonomike, asociacionet e biznesit, Organizatat Rinore dhe të shoqërisë civile, agjencitë zhvillimore etj të cilat e mbështesin ndërmarrësinë tek të rinjtë. Themelimi i këtij trupi formal koordinues pritet të përmirësojë rrjedhën e informacionit ndërmjet të të gjitha palëve të interesit për mundësitë e përkrahjes së ndërmarrësisë tek të rinjtë kosovarë, gjithashtu të koordinojë veprimet dhe ndërmarrjen e masave në mënyrë të përbashkët.

#### *2.2.6 Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me këshillim dhe orientim në karrierë, shkathtësim dhe ndërmjetësim të rinisë me tregun e punës*

Zbutja e shkallës së papunësisë në mesin e të rinjve kosovarë nuk shihet vetëm si barrë e institucioneve shtetërore por e tërë shoqërisë. Për këtë qëllim DiR do të përkrahë, përmes granteve të vogla, të gjitha Organizatat Rinore të cilat aplikojnë me ide kreative dhe punojnë në programe të këshillimit dhe të orientimit në karrierë, në shkathtësim dhe sidomos në ndërmjetësim të rinisë me tregun e punës. Kjo përkrahje e Organizatave Rinore nga DiR planifikohet të jetë në baza vjetore, gjersa pritet që një veprim të këtillë ta ndjekin edhe institucionet e qeverisjes lokale, si praktikë e sukseshme që i kontribuon zvogëlimit të papunësisë tek të rinjtë kosovarë.

#### *2.2.7 Organizimi i ngjarjeve promovuese me komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesit për mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit të të rinjve*

DiR dhe partnerët e tjerë strategjikë do t'i shtojnë aktivitetet e tyre të cilat i promovojnë mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit të të rinjve në vend. Planifikohet që aktivitetet promovuese të organizohen së bashku me komunitetin e biznesit dhe me palët tjera të interesit, të cilat e shohin vetë punësimin si mundësi optimale bazuar në rrethanat aktuale. Me këto veprime pritet që komuniteti i biznesit të njoftohet me kohë për potencialin, shkathësitë dhe mundësitë të cilat rinia kosovare i zotëron, andaj një veprim i këtillë ndjeshëm i kontribuon ndërtimit të besueshmërisë së ndërsjellë ndërmjet një biznesi dhe një të riu punë kërkuar. Ngjarjet promovuese janë të planifikuara të ndërmerren përmes organizimit të fushatave adekuate.

#### *2.2.8 Përkrahja e nismave kreative për themelimin e bizneseve të reja të të rinjve*

Nisja e bizneseve të reja është një veprim i guximshëm i cili përkon pikërisht me natyrën e një të riu i cili paraprakisht i shtjerrë të gjitha mundësitë për të siguruar një vend të qëndrueshëm pune. Ndër mundësitë më të shpeshta të punësimit të shpejtë shihet themelimi i bizneseve vetanake/fillestare, por kjo përpos njohurive për udhëheqjen e biznesit kërkon edhe mbështetje fillestare financiare, gjë që një i ri kosovar, me apo pa thirrje akademike, nuk



mund t'ia ofrojë vetes një mundësi të tillë. Për këtë qëllim DiR do të mbështesë me grante nismat kreative për themelimin e bizneseve të reja të cilat udhëhiqen nga të rinjtë dhe të cilat gjenerojnë vende të reja të punës. Kjo masë e DiR planifikohet të jetë në baza vjetore, gjersa shihet si veprim afirmativ/stimulues për të gjithë të rinjtë të cilët përcaktohen për vetë punësimi, si veprimtari më e shpeshtë dhe e preferuar e punësimit tek gjeneratat e reja.

### **3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë**

#### **3.1 Promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenjes së të rinjve**

##### *3.1.1 Organizimi i ngjarjeve ndërgjegjësuese për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë*

Dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë konsiderohen të jenë devijime sociale të cilat më së shpeshti e sulmojnë moshën adoleshente dhe rininë e hershme, përfshirë shoqëritë në tranzicion. Andaj as vendi ynë nuk bën përjashtim nga kjo veti e shëmtuar e shoqërisë kosovare. Me qëllim të parandalimit të përhapjes së këtyre dukurive negative, DiR me ndihmën e Organizatave Rinore dhe partnerëve strategjikë planifikon të organizojë ngjarje ndërgjegjësuese për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë në Kosovë. Ngjarjet e tilla, në formë fushate, përbëjnë TV spotet, TV dhe radio debatet, tryezat e diskutimit në komuna të ndryshme, shpërndarja e materialeve të shtypura dhe prezantimi i tyre në rrjetet sociale dhe mediet elektronike.

##### *3.1.2 Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me promovimin e mjedisit të shëndetshëm*

Mjedi i shëndetshëm është një parakusht për zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë dhe me mirëqenie, sidomos të rinjve. Përpos familjes si bërthamë e rëndësishme e funksionimit të duhur të sistemit shoqëror, në kohët e sotme një pjesë bukur e madhe e barrës i bie edhe organizatave të shoqërisë civile, sidomos të Organizatave Rinore. Për këtë qëllim DiR do të mbështesë ato dhe nismat e ndryshme që merren me promovimin e mjedisit të shëndetshëm me grante të vogla në baza vjetore. Mbështetja nuk do të kufizohet vetëm në ndërgjegjësim për rëndësinë e të pasurit një mjedis të shëndetshëm, por edhe përkrahjen e të rinjve që marrin pjesë në konferenca, punëtori, trajnime, seminare, kampe, debate të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për çështjet e shëndetësisë për të rinjtë. Këtu përfshihet edhe promovimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve për ruajtjen e shëndetit riprodhues, të drejtat dhe obligimet e tyre.

##### *3.1.3 Përkrahja e Organizatave Rinore që përmes fushatave, trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera promovojnë mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë, duke përfshirë ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike, përdorimin e substancave të dëmshme, marrjen me aktivitete fizike etj.*

Mënyra e shëndetshme e të jetuarit tek të rinjtë, duke përfshirë ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike, përdorimin e substancave të dëmshme si akooli, duhani dhe substancat narkotike, marrjen me aktivitete fizike, rekreative dhe sportive, konsiderohen masa të rëndësishme të veçantë për një zhvillim të shëndoshë të rinisë. Për këtë qëllim DiR do të përkrahë financiarisht Organizatat Rinore të cilat

organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese dhe promovuese për mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë. Me qëllim të bashkërenditjes së veprimeve me institucionet e qeverisjes lokale dhe njëkohësisht edhe të ndërtimit të kapaciteteve të tyre lidhur me ndërmjetësimin me komunitetin rinor, marrësit e granteve do të kushtëzohen të ndërveprojnë me institucionet gjegjëse lokale apo qendrore, varësisht prej natyrës së projekteve.

#### *3.1.4 Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë që cenojnë shëndetin*

Gjersa në njërin anë Organizatat Rinore përfitojnë nga DiR për këtë qëllim, në anën tjetër vet DiR planifikon të ndërmerret aktivitete promovuese dhe ndërgjegjësuese, të cilën e bën përmes shënimit të ditëve të ndryshme lidhur me shëndetin. Përveç këtyre aktiviteteve që I organizon vet DiR, ndihmë logjistike pritet edhe nga Organizatat Rinore të cilat i kontribuojnë promovimit dhe ndërgjegjësimi të rinjve për dukuritë që e cenojnë shëndetin e tyre. Pritet që rol të rëndësishëm në këtë proces ndërgjegjësues dhe promovues të kenë Qendrat Rinore, për arsye të numrit të gjerë të frekuentuesve në aktivitete e tyre. Pjesë e këtyre aktiviteteve ndërgjegjësuese planifikohet të jenë edhe institucionet relevante shëndetësore, të cilat me këshillat dhe rekomandimet e tyre profesionale pritet t'i kontribuojnë parandalimit të dukurive që e cenojnë shëndetin e të rinjve.

### **3.2 Rritja e sigurisë së rinisë**

#### *3.2.1 Organizohen hulumtime të thella për dukuritë që cenojnë mjedisin e sigurtë dhe të shëndetshëm të rinisë*

Rreziqet që kanosin rininë janë të shumta, sidomos kur jemi shoqëri në tranzicion dhe në proces të pozicionimit sa më të mirë të rinisë në shoqëri. Veprimet për të shmangur rreziqet, zbutur kanosjet janë më se të domosdoshme. Para se të ndërmerren veprime të tilla të strukturuar dhe të planifikuara mirë, nevojiten hulumtime të thella mbi dukuritë apo rrethanat që kanosin rininë. Për këtë qëllim DiR do të organizojë hulumtime të thella për dukuritë që e cenojnë mjedisin e sigurtë dhe të shëndetshëm të rinisë, qoftë përmes burimeve vetanake apo atyre të konsulencës profesionale. Planifikohet që të kryhen të paktën 10 hulumtime të ndryshme të cilat e sfidojnë mjedisin e sigurtë të të rinjve në vend, të cilat do të mbështeten nga DiR. Të gjeturat nga këto hulumtime do të shërbejnë për të planifikuar, adresuar dhe të ndërmarrë aktivitetet konkrete të cilat i kontribuojnë ndërtimit të një mjedisi të sigurtë dhe të shëndetshëm të rinisë kosovare.

#### *3.2.2 Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me ndërgjegjësimin për mjedisi të sigurtë*

Ndërmjetësit më të mirë mes DiR dhe komunitetit rinor që përfaqëson janë Organizatat Rinore. Ato mund të përçojnë mesazhet drejtpërdrejt tek rinia lidhur me mjedisin e sigurt dhe të shëndetshëm. Për këtë qëllim DiR, në bazë vjetore, do të mbështesë Organizatat Rinore që

kanë nisma kreative për të pasur një mjedis të sigurtë. Përkrahja e të rinjve planifikohet duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, punëtori, trajnime, seminare, kampe, debate të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për çështjet e sigurisë përfshirë promovimin e lëvizjes së lirë.

### *3.2.3 Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të institucioneve qendrore dhe lokale të sektoreve të rinisë për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të sigurtë për të rinjtë*

Hartuesit e politikave dhe punëtorët e autoriteteve shtetërore për rini, në të gjitha rrafshet e qeverisjes, duhen të kenë njohuri të mjaftueshme por edhe kompetencë për t'u marrë me veprimet që çojnë drejt përmirësimit të mjedisit të sigurt për rininë. Me qëllim që të ngriten kapacitetet e tilla, DiR planifikon të organizojë trajnime të strukturuar për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, nga rreziqet e ndryshme nga interneti, nga terrorizmi dhe kërcënimet tjera të cilat e cenojnë mjedisin e sigurtë për të rinjtë kosovarë.

### *3.2.4 Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të Organizatave Rinore për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm dhe të sigurtë për të rinjtë*

Me qëllim të ruajtjes dhe të promovimit të mjedisit të sigurtë të rinisë kosovare, DiR do të ngrisë kapacitete të personelit të Organizatave Rinore nëpër qendra të ndryshme të vendit. Ngritja e kapaciteteve do të bëhet përmes trajnimeve të strukturuar për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, nga rreziqet e ndryshme nga interneti, nga terrorizmi dhe kërcënimet tjera të cilat e cenojnë mjedisin e sigurtë për të rinjtë kosovarë. Pakot trajnuese u dedikohen punëtorëve rinorë pjesë të Organizatave Rinore nga i gjithë vendi. Këto trajnime planifikohen të organizohen në mënyrë të vazhdueshme në baza vjetore.

### *3.2.5 Ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë negative shoqërore si trafikimi, ekstremizmi, kriminaliteti etj përfshirë parandalimin*

Dukuritë devijuese tek të rinjtë si trafikimi me qenie njerëzore dhe narkotikë, ekstremizmi i dhunshëm, kriminaliteti dhe terrorizmi ideologjik, janë disa nga sfidat e vazhdueshme me të cilat konfrontohen shtetet në tranzicion dhe me demokraci të brishtë. Duke dëshiruar që vendi ynë të mos i takojë vendeve të tilla, DiR planifikon të ndërmerr aktivitete të shtuara me qëllim ndërgjegjësimi. Aktivitetet e tilla planifikohen të kryhen në formë fushatash nga vet DiR, të ndihmuar nga Organizatat Rinore të cilat punojnë në ndërgjegjësimin e rinisë për dukuritë negative shoqërore.

### *3.2.6 Organizimi i kampit tradicional rinor që promovon sigurinë si dhe promovimin e paqes për të gjithë etnitë*

Me qëllim të promovimit të sigurisë dhe të paqes së qëndrueshme për të gjitha etnitë, DiR planifikon të organizojë “Kampin Tradicional Rinor”. Kampi pritet të jetë aktivitet vjetor që do të zgjasë së paku 5 ditë dhe i cili do të grumbullojë mbi 200 të rinj nga të gjitha etnitë të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës. Ky organizim përveç që ka karakter të promovimit të paqes dhe të sigurisë, njëkohësisht shërben edhe për të shkëmbyer përvojat, dijet dhe njohuritë ndërmjet të rinjve, kështu duke rezultuar në ndërtimin e mirëbesimit ndërmjet të rinjve, gjersa pritet që kampi tradicional të përcjelllet me module të ndryshme të punës si ngritja e kapaciteteve në shkrim projektesh, në ngritje fondesh, në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Organizatave Rinore, si dhe aktivitete të tjera të cilat do të identifikohen nga vetë pjesëmarrësit në kamp.

### *3.2.7 Përkrahja e Organizatave Rinore lidhur me realizimin e intervenimit të hershëm në komunitet*

Intervenimi i hershëm i referohet aktiviteteve, programeve apo nismave, të disenjuara që të ndryshojnë modelet e sjelljes ose zhvillimin e të rinjve të cilët tregojnë shenja të një problemi të caktuar, duke siguruar burimet dhe shkathtësitë e nevojshme për të luftuar rreziqet e identifikuar. Intervenimi i hershëm përfshin intervenimin në fazën e hershme të formimit të personalitetit sikurse që janë të rinjtë, për t’i siguruar ata se do të përkrahen pikërisht në vitet e formësimit individual, kur më së tepërmi kanë nevojë. Me një fjalë, i referohet metodologjive specifike lidhur me ndërhyrjen sa më shpejtë në çastin e parë kur një problem bëhet i dukshëm. Një ndër synimet e intervenimit të hershëm është që të parandalohet eskalimi i çështjeve serioze të cilat më pas mund të kërkojnë përgjigje apo reagim më intenziv duke përfshirë sistemin ligjor. Për këtë qëllim DiR planifikon të përkrahë financiarisht projektet e Organizatave Rinore që kanë nisma kreative lidhur me intervenimin e hershëm, praktikë kjo e përditshme në vendet e përparuara.

## **3.3 Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative**

### *3.3.1 Integrimi shoqëror i të rinjve përmes kulturës, sportit dhe rekreacionit*

Aktivitetet sportive dhe rekreative janë treguar mjet shumë i fuqishëm në integrimin shoqëror të grupeve të marginalizuara por edhe si mjet shumë pozitivë për zhvillimin e personalitetit të një të riu apo të reje. Kultura poashtu është pjesë tepër e rëndësishme e të mësuarit për shoqërinë dhe historinë e shoqërisë sonë ku kyçja e të rinjve në promovimin e kulturës sonë në moshë sa më të hershme ka beneficione si për të rinjtë ashtu edhe për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës sonë. Me synim të luftimit të paragjykimeve që ende ekzistojnë ndërmjet komuniteteve, njohja e kulturave të etnive të ndryshme, i kontribuon paqës dhe sigurisë në Kosovë.

### *3.3.2 Organizimi aktiviteve tradicionale për të rinjtë.*

Departamenti i Rinisë që nga themelimi ka organizuar ngjarje dhe aktivitete të ndryshme për vetëdijësimin e shoqërisë lidhur me rininë si pasuria më e madhe që e ka Kosova. Në kuadër të këtyre organizimeve këtu duhet të përmendim muajin e rinisë që tashmë 15 vite organizohet nga departamenti si dhe Ditën Ndërkombëtare të Rinisë që shënohet më 12 Gusht. Synimet e departamentit janë që përmes këtyre aktiviteve tradicionale të vazhdojmë me rritjen e sensibilizimit për rëndësinë e afirmimit dhe avancimit të pozitës së të rinjve në popullatën e përgjithshme të Kosovës.

### *3.3.3 Përkrahja e të rinjve në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sportit dhe kulturës.*

Në Kosovë të rinjëve u ofrohet mbështetje mjaft e madhe për të marr pjesë por edhe për të zhvilluar ngjarje dhe iniciativa të ndryshme sportive dhe kulturore të frymës profesionale. Mirëpo, në rastet kur iniciativat në fushën e sportit dhe kulturës janë më pak të karakterit profesional, e më shumë të karakterit shoqëruar, rekreativë e kështu me radhë, mbështetja është e vogël dhe i vetmi institucion që ofron mbështetje të kësaj forme është departamenti i rinisë. Pra, sporti dhe kultura për të rinjtë duhet të shihen edhe në aspektin social si mekanizma shumë të efektshëm për ngritjen e tyre personale përgjatë jetës së tyre. Në BE dhe shumë vende tjera të botës organizohen ngjarje shumë të rëndësishme të kësaj fryme në fushën e sportit dhe kulturës dhe përmes kësaj mase departamenti i rinisë do të ndan një buxhet solid për mbështetjen e të rinjve që të jenë pjesë e këtyre ngjarjeve ndërkombëtare.

### *3.3.4 Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve*

Shteti i Kosovës në vazhdimësi është duke punuar me prioritet të lartë në rritjen e mireqenies së gjithë qytetarëve të saj, në luftimin e paragjyqimeve dhe marginalizimit, krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për të jetuar, promovon ndërtimin e paqes dhe të mirëbesimit duke u ofruar të gjithë qytetarëve të saj mundësi të barabarta për zhvillim. Departamenti i Rinisë do të mbështet aktivitete dhe projekte që janë të fokusuar në ndërtimin dhe rritjen e kohezionit social ndëretnik si dhe do të përkrah dialogun dhe komunikimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë.

### *3.3.5 Mbështetja e femrave të reja dhe të rinjve në zonat rurale*

Të gjitha analizat në sektorin e rinisë tregojnë se ka një dallim në nivelin e avancimit të femrave të reja në krahasim me të rinjtë e gjinisë mashkullore së paku me 20% në të gjitha fushat, ku mundësitë për gjininë femrore janë shumë më kufizuese dhe të pakta. Të dhënat tregojnë se poashtu ekziston një dallim mjaft i theksuar lidhur me mundësitë e të rinjëve që jetojnë në zonat urbane kundrejt atyre që jetojnë në zonat rurale, kjo në disfavor të zonave rurale me së paku 10%. Nëse je femër e re dhe jeton në zonat rurale, opsionet dhe shanset zvogëlohen në mënyrë të theksuar. Departamenti i Rinisë duke pasur parasysh këto të dhëna do të përqendrohet me zhvillimin e programeve dhe projekteve për këto dy grupe të ndieshme të të rinjve duke ofruar projekte specifike në favor të tyre.

## PLANI I VEPRIMIT

**Objektivi strategjik 1:** Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive

Objektivi specifik 1.1	Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Organizatave Rinore											
	Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
							2019	2020	2021	2022	2023	Totali
1.1.1	Ngritja e kapaciteteve për Organizatat Rinore lidhur me zhvillimin organizativ	X - XII të secilit vit	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore	10 grupe trajnimi (30 pjesëmarrës) x 2 ditë trajnimi x 600 Eur	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	60,000	
1.1.2	Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve rinorë komunalë	I - III të secilit vit	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Komunat	10 grupe (20 pjesëmarrës) x 2 ditë trajnimi x 800 Eur	-	16,000	16,000	16,000	16,000	64,000	
1.1.3	Përkrahja e nismave që mundësojnë krijimin e rrjeteve formale dhe joformale	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	/	Deri në 3 rrjete në vit x deri në 3.500 Eur	10,500	10,500	10,500	10,500	10,500	52,500	
1.1.4	Mbështetja e projekteve ose nismave për aktivizmin rinor në komunitet / mobilitetin rinor	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	/	Deri në 20 Organizata Rinore në vit x deri në 4.000 Eur	80,000	150,000	150,000	150,000	150,000	680,000	



1.1.5	Përkrahja e Organizatave Rinore përmes sigurimit të kontributit / pjesëmarrjes gjatë aplikimit në fondet e agjencive zhvillimore dhe programeve të tyre	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore	Deri në 10 Organizata Rinore në vit x deri në 20.000 Eur	30,000	100,000	100,000	100,000	100,000	430,000
1.1.6	Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërgjegjësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve, përfshirë Zyrën Rajonale për bashkëpunim Rinor RYCO	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	/	Deri në 5 Organizata Rinore në vit x deri në 20.000 Eur	100,000	100,000	100,000	100,000	100,000	500,000
Nën-Totali 1.1						232,500	388,500	388,500	388,500	388,500	1,786,500
<b>Objektivi specifik 1.2</b>	Konsolidimi i legjislacionit për rininë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali
1.2.1	Promovimi i mekanizmave ligjorë për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	/	Të paktën një spot medial në vit	2,000	4,000	4,000	4,000	4,000	18,000

1.2.2	Realizimi i hulumtimeve lidhur me gjendjen e sektorit të rinisë dhe monitorimi i rregullt i zbatueshmërisë së legjislacionit lidhur me pjesëmarrjen	Që nga IV 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore	Angazhimi i konsulencës x 3 hulumtime në vit x 3.000 Eur	-	9,000	9,000	9,000	9,000	36,000	
1.2.3	Krijimi i platformës dixhitale për legjislacionin primar, sekondar, nismat ligjore, politikat rinore, strategjitë lokale dhe planet e veprimit në shërbim të të gjitha organizatave rinore	I - IV 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore Komunitat	Krijimi i platformës dixhitale x 6.000 Eur Mirëmbajtja vjetore x 1.000 Eur	-	7,000	1,000	1,000	1,000	10,000	
Nën-Totali 1.2							2,000	20,000	14,000	14,000	14,000	64,000
<b>Objektivi specifik 1.3</b>	Përkrahja për mobilitetin rinor											
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)						
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali	
1.3.1	Ndërgjegjësimi i komunitetit rinor për pjesëmarrje dhe qytetari aktive	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	/	Të paktën 2 ngjarje mediale x 2000 Eur	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	20,000	

1.3.2	Ofrimi i mbështetjes për ndërtimin dhe rehabilitimin e qendrave rinore, përfshirë ndërtimin dhe rehabilitimin e terreneve rekreative dhe sportive për zhvillim të aktiviteteve sociale të të rinjve	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore	Ngritja e të paktën një Qendre Rinore në vit x 250.000 Eur Fondi vjetor për rehabilitim infrastrukturor x 100.000 Eur	250,000	350,000	350,000	350,000	350,000	1,650,000
1.3.3	Inventarizimi, përditësimi dhe katalogizimi i shërbimeve të Organizatave Rinore që ofrohen për të rinjtë	V - X 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Organizatave Rinore	Katalogu i përditësuar çdo dy muaj	-	-	-	-	-	-
1.3.4	Ndarja e fondit të veçantë për mobilitetin rinor - fondi rinor	Që nga VII 2019	MKRS	Agjencitë zhvillimore		450,000	450,000	450,000	450,000	450,000	2,250,000
Nën-Totali 1.3						704,000	804,000	804,000	804,000	804,000	3,920,000
<b>Objektivi specifik 1.4</b>	Zhvillimi i vullnetarizmit										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali
1.4.1	Promovimi i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Promovimi i vazhdueshëm në çdo pjesëmarrje të divizionit në ngjarje publike dhe takime	-	-	-	-	-	-

1.4.2	Menaxhimi i procesit të punës vullnetare	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	MKRS	Angazhimi i konsulencës x 1 hulumtim x 2.500 Eur	-	2,500	-	-	-	2,500
1.4.3	Njohje e punës vullnetare të të rinjve nga DiR të cilët rekomandohen nga organizatat rinore që ofrojnë punë vullnetare	I - IV 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	MKRS	Përditësimi i listave të punës vullnetare	-	-	-	-	-	-
1.4.4	Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë vullnetarizmin dhe punën vullnetare	Që nga I 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Deri në 20 Organizata Rinore në vit x deri në 3.000 Eur	-	60,000	60,000	60,000	60,000	240,000
Nën-Totali 1.4						-	62,500	60,000	60,000	60,000	242,500

**Totali i Objektivit**

**Strategjik 1: 938,500 1,275,000 1,266,500 1,266,500 1,266,500 6,013,000**

**Objektivi Strategjik 2:** Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës

<b>Objektivi specifik 2.1</b>	Zhvillimi i edukimit jo formal										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali

2.1.1	Organizimi dhe mbështetja e ngjarjeve me qëllim aftësimin e të rinjve përmes edukimit jo formal	Që nga I 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore	Së paku 3000 të rinjë përfitues (100 aktivitete: seminare, trajnime, tryeza, debate, punëtori, shkëmbim të përvojave, aktivitete që krijojnë mundësi dhe hapsirë për të rinjë nga Kosova dhe Diaspora, vizita studimore, kampe TEDx, tryeza, sesione informuese etj që ndihmojnë aftësimin e të rinjve përmes edukimit jo formal.	100,000	130,000	150,000	170,000	190,000	740,000
2.1.2	Organizimi ngjarjeve për promovimin e edukimit jo formal	Që nga I 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore	Një spot medial Të paktën një panair për vit, Të paktën 1 konferencë për vit, Të paktën 15 fushata (sesione informuese) në vit, Tri ngjarje publike me karakter të promovimit të Edukimit jo formal	30,000	40,000	50,000	60,000	70,000	250,000
Nën-Totali 2.1						130,000	170,000	200,000	230,000	260,000	990,000
<b>Objektivi specifik 2.2</b>	Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës										
Kodi	Aktiviteti	Periodha e	Përgjegjësia	Institucioni/organizata	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					

		implementimit		mbështetëse		2019	2020	2021	2022	2023	Totali
2.2.1	Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës	Që nga VII 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	/	4 fushata promovuese në vit x 2.000 Eur	6,000	8,000	8,000	8,000	8,000	38,000
2.2.2	Organizimi dhe përkrahja e panairëve për informimin e të rinjve mbi rëndësinë dhe nxitjen e tyre për kyçje në tregun e punës	Që nga VII 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore Asociacione të biznesit	Deri në 4 panairë x deri në 10.000 Eur	20,000	40,000	40,000	40,000	40,000	180,000
2.2.3	Përcaktimi i prioritetëve dhe i deficiteve në tregun e punës përmes hulumtimeve të vazhdueshme	Që nga VII 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore	Angazhimi i konsulencës x deri në 3 hulumtime për gjendjen e ndërmarrësisë së të rinjve në vit x 3.000 Eur	3,000	9,000	9,000	9,000	9,000	39,000
2.2.4	Hartimi i kriterëve dhe i standardeve për përkrahjen për ndërmarrësitë rinore, dhe i udhërrëfyesve për ndërmarrësitë që kanë synim rininë	IX - XII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Angazhimi i konsulencës x 1 hulumtim x 1.500 Eur	1,500	-	-	-	-	1,500
2.2.5	Themelimi i trupit koordinues për përkrahjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë me përfshirje të gjerë të hisedarëve shtetërorë dhe agjencie	XI - XII 2019	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Trupi koordinues i themeluar	-	-	-	-	-	-

	zhvillimore										
2.2.6	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me këshillim dhe orientim në karrierë, shkathtësim dhe ndërmjetësim të rinisë me tregun e punës	Që nga VII 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	/	Deri në 10 Organizata Rinore në vit x deri në 10.000 Eur	20,000	100,000	100,000	100,000	100,000	420,000
2.2.7	Organizimi i ngjarjeve promovuese me komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesit për mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit të të rinjve	Që nga VII 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore Asociacione të biznesit	4 fushata promovuese në vit x 2.000 Eur	4,000	8,000	8,000	8,000	8,000	36,000
2.2.8	Përkrahja e nismave kreative për themelimin e bizneseve / ndërmarrësive të reja të të rinjve	Që nga I 2019	Divizioni për Promovim dhe Zhvillim të Edukimit Joformal	Agjencitë zhvillimore	Deri në 60 nisma të ndërmarrësisë në vit x 5.000 Eur	150,000	300,000	300,000	300,000	300,000	1,350,000
Nën-Totali 2.2											
						204,500	465,000	465,000	465,000	465,000	2,064,500

**Totali i Objektivit**

**Strategjik 2: 334,500 635,000 665,000 695,000 725,000 3,054,500**

**Objektivi Strategjik 3:** Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

Objektivi specifik 3.1	Promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenjes së të rinjve											
	Kodi	Aktiviteti	Periodha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					Totali
							2019	2020	2021	2022	2023	
3.1.1	Organizimi i ngjarjeve ndërgjegjësuese për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	4 fushata në vit x deri në 2.000 Eur	4,000	8,000	8,000	8,000	8,000	36,000	
3.1.2	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me promovimin e mjedisit të shëndetshëm	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Deri në 15 Organizata Rinore në vit x deri në 2.000 Eur	15,000	30,000	30,000	30,000	30,000	135,000	
3.1.3	Përkrahja e Organizatave Rinore që përmes fushatave, trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera promovojnë mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë, duke përfshirë	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Deri në 20 Organizata Rinore në vit x deri në 3.000 Eur	30,000	60,000	60,000	60,000	60,000	270,000	



	ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike, përdorimin e substancave të dëmshme, marrjen me aktivitete fizike etj										
3.1.4	Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë që cenojnë shëndetin	Që nga I 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	Organizatrat Rinore	Deri në 10 Organizata Rinore në vit x deri në 500 Eur për organizim të përbashkët me DiR	-	5,000	5,000	5,000	5,000	20,000
Nën-Totali 3.1						49,000	103,000	103,000	103,000	103,000	461,000
<b>Objektivi specifik 3.2</b>	Rritja e sigurisë së rinisë										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali
3.2.1	Organizohen hulumtime të thella për dukuritë që cenojnë mjedisin e sigurtë dhe të shëndetshëm të rinisë	Që nga VII 2019	Divizioni për Zhvillim të Politikave Rinore	Agjencitë zhvillimore Organizatat Rinore	Angazhimi i konsulencës x 6 hulumtime në vit x deri në 4.000 Eur	4,000	24,000	24,000	24,000	24,000	100,000

3.2.2	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me ndërgjegjësimin për mjedis të sigurtë	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Deri në 20 Organizata Rinore në vit x deri në 5.000 Eur	25,000	100,000	100,000	100,000	100,000	425,000
3.2.3	Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të institucioneve qendrore dhe lokale të sektoreve të rinisë për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të sigurtë për të rinjtë	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	5 grupe (20 pjesëmarrës) x 2 ditë trajnimi x 800 Eur	2,400	8,000	8,000	8,000	8,000	34,400
3.2.4	Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të Organizatave Rinore për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm për të rinjtë	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	10 grupe (25 pjesëmarrës) x 2 ditë trajnimi x 2.000 Eur	20,000	40,000	40,000	40,000	40,000	180,000
3.2.5	Ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë negative shoqërore si trafikimi, ekstremizmi, kriminaliteti etj përfshirë parandalimin	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	5 fushata tematike në vit x deri në 2.000 Eur	4,000	10,000	10,000	10,000	10,000	44,000

3.2.6	Organizimi i kampit tradicional rinor që promovon sigurinë si dhe promovimin e paqes për të gjitha etnitë	VI - VIII të secilit vit	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	Agjencitë zhvillimore Organizatat Rinore	Të paktën 200 të rinj x 300 Eur (deri në 5 kampe në vit)	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	300,000
3.2.7	Përkrahja e Organizatave Rinore lidhur me realizimin e intervenimit të hershëm në komunitet	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror		Deri në 20 Organizata Rinore në vit x deri në 4.000 Eur	40,000	80,000	80,000	80,000	80,000	360,000
Nën-Totali 3.2						155,400	322,000	322,000	322,000	322,000	1,443,400
<b>Objektivi specifik 3.3</b>	Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative										
Kodi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Përgjegjësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Treguesi	B U X H E T I (EURO)					
						2019	2020	2021	2022	2023	Totali
3.3.1	Integrimi shoqëror i të rinjve përmes kulturës, sportit dhe rekreacionit	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror		Deri në 20 projekteve dhe kanë përfituar 2000 të rinj në vit.	35,000	40,000	40,000	40,000	40,000	195,000
3.3.2	Organizimi aktivitetesh tradicionale për të rinjtë.	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të ditës ndërkombëtare së rinisë 12 gushtit, muajit të rinisë,	20,000	25,000	25,000	30,000	30,000	130,000
3.3.3	Përkrahja e të rinjve në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Të mbështeten 20 të rinjë në shkëmbimet e eksperiencave në nivel	10,000	10,000	10,000	15,000	15,000	60,000

	sportit dhe kulturës.				ndërkombëtar të artistëve dhe sportistëve të rinj, duke i bërë të rinjtë kosovar pjesë të proceseve rinore ndërkombëtare						
3.3.4	Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Janë realizuar 10 seminare/punëtori, debate, tryeza, apo shkëmbimeve të përvojave. Kanë përfituar 200 të rinj për vit, për rritjen e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve.	15,000	15,000	20,000	30,000	30,000	110,000
3.3.5	Mbështetja e femrave të reja dhe të rinjve në zonat rurale	Që nga VII 2019	Divizioni për Parandalim dhe Integrim Shoqëror	/	Janë përkrahur 20 projekte në vit. Janë realizuar 5 ngjarje avokuese për përfshirjen e femrave të reja dhe të rinjve nga zonat rurale	35,000	40,000	40,000	40,000	40,000	195,000
Nën-Totali 3.3						115,000	130,000	135,000	155,000	155,000	690,000

**Totali i Objektivit**

**Strategjik 3: 319,400 555,000 560,000 580,000 580,000 2,594,400**